



Bashkimi Evropian

Paneli për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut Kosovë

Raport vjetor

1 janar - 31 dhjetor 2013

Paneli për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut - Sekretariati

Rr. Rustem Statovci nr. 29 – 10000 Prishtinë – Kosovë

Tel: +381 (0) 38 78 2125

Email: office@hrrp.eu

www.hrrp.eu

Përmbajtja

Parathënie.....	5
1. Hyrje.....	7
2. Korniza rregulluese	8
2.1. Veprimi i përbashkët i Këshillit 2008/124/CFSP i datës 4 shkurt 2008 lidhur me Misionin Evropian për Sundimin e Ligjit në Kosovë, EULEX-i KOSOVË.	8
2.2. Koncepti llogaridhënës i EULEX-it në Kosovë – Paneli për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut, Sekretariati i Përgjithshëm i Këshillit, Bruksel, i datës 29 tetor 2009.....	8
2.3. Instrumentet e zbatueshme ndërkombëtare të të drejtave të njeriut.....	8
3. Paneli dhe Sekretariati.....	10
3.1. E përgjithshme	10
3.2. Anëtarët e Panelit – Të dhëna biografike	10
4. Numri i lëndëve dhe subjekti i ankesave	14
4.1. Numri i lëndëve dhe statistikat.....	14
4.2. Trendët.....	14
4.3. Subjekti i ankesave.....	15
5. Jurisprudenca	17
5.1. Meritat	17
5.1.1. <i>W kundër EULEX-it</i> – zbulimi i informacionit lidhur me identitetin e dëshmitarit	17
5.1.2. Lëndët e <i>Vidovdanit</i> – obligimi i EULEX-it për të mbrojtur të drejtat e njeriut	18
5.2. Pranueshmëria.....	20
5.2.1. Kompetenca e Panelit për shqyrtimin e procedurave të gjykatave në Kosovë	20
5.2.2. Kompetenca e Panelit për të shqyrtuar ligjshmërinë dhe kohëzgjatjen e paraburgimit	20
5.2.3. Monitorimi, udhëzimi, këshillimi dhe mandati ekzekutiv i EULEX-it	20
5.2.4. Statusi i viktimës	21
5.2.5. Korrupsioni dhe të drejtat e njeriut	22
5.2.6. Ri-shqyrtimi i një ankese	22
5.2.7. Neni 3 i KEDNj	22
6. Aktivitetet e Panelit	24
6.1. Fushata publike informuese 2013.....	24
6.2. Trajnimi hyrës për personelin e EULEX-it.....	25
6.3. Faqja e internetit.....	25
7. Çështjet operative/administrative/të personelit.....	26
7.1. Papranueshmëria e ankesave	26
7.2. Buxheti	26
8. Komentim ndërkombëtar sa i përket llogaridhënies së të drejtave të njeriut për misionet ndërkombëtare në Kosovë.....	27
8.1. “Veçantia evropiane?”	27

8.2.	“Krijimi i llogaridhënies për organizatat ndër-qeveritare dhe shtete”	27
8.3.	“Përgjegjësia e organizatave ndërkombëtare për shkeljet e të drejtave të njeriut”	31
8.4.	Raporti i Amnesty International “Kosovë – Trashëgimia e UNMIK-ut”	33
8.5.	Vendimi i papranueshmërisë i Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut në lëndën Azemi kundër Serbisë	35
9.	E ardhmja e EULEX-it dhe sfidat e të drejtave të njeriut që del përpara	37
10.	Vërejtjet përfundimtare	39
SHTOJCA 1	Tabela e personelit	40
SHTOJCA 2	Orari i fushatës informuese dhe aktivitetet e tjera	41
SHTOJCA 3	Statistikat 2010 - 2013	44
SHTOJCA 4	Vendimet e PShDNj-së 2010-2013	45

Parathënie

Ky është raporti i katërt vjetor i Panelit për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut (më tutje: "Paneli"). Si në vitet e mëparshme, Paneli ka vazhduar gjatë gjithë periudhës raportuese me shqyrtimin e ankesave të shkeljeve të të drejtave të njeriut nga EULEX-i në Kosovë gjatë ushtrimit të mandatit të tij ekzekutiv në drejtësi, polici dhe doganë.

Në vitin 2013, Paneli ka mbajtur pesë seanca dhe ka pasur një rritje të konsiderueshme të numrit të lëndëve, duke i pranuar 27 ankesa të reja. Gjatë periudhës së raportimit, Paneli ka shqyrtuar 21 ankesa. Paneli ka gjetur se në shtatë prej këtyre ankesave ka pasur shkelje të të drejtave të njeriut.

Shkeljet e të drejtave të njeriut nga ana e EULEX-it kanë të bëjnë me veprimet dhe mosveprimet e Misionit në respektimin, mbrojtjen dhe garantimin e të drejtave të njeriut të ankuesve. Ka pasur dy vendime nga Paneli në lidhje me të ashtuquajturën festimet e *Vidovdanit* që mbahen në Kosovë çdo vit në qershor. Paneli ka konstatuar se EULEX-i nuk kishte arritur të ofroj burime të mjaftueshme dhe të kryej planifikim të duhur në mënyrë që të ruhet rendi publik, siç është përcaktuar me mandatin e tij. Kjo kishte rezultuar në shkelje të të drejtave të një numri të pjesëmarrësve në ato ngjarje.

Shkelje të mëtejshme janë vërejtur nga Paneli në një rast që ka përfshirë shpërndarjen e të dhënave personale të një dëshmitari të mundshëm në një rast të krimeve të luftës nga ana e prokurorëve të EULEX-it tek autoritetet e caktuara të ndjekjes penale. Shkeljet kanë përfshirë të drejtën për respektimin e jetës private dhe familjare, lirisë së mendimit, ndërgjegjes dhe besimit, lirisë së tubimit dhe organizimit si dhe të drejtës në mjete efektive.

Paneli ka dorëzuar rekomandimet tek shefi i Misionit të EULEX-it për t'i adresuar ato shkeljet dhe ato që janë përmendur në lëndët e tjera. Në një lëndë, Paneli ka nxjerrë një vendim pasues, duke konsideruar se shefi i Misionit nuk kishte arritur t'i zbatonte të gjitha rekomandimet e Panelit. Këto vendime janë diskutuar më tutje në mënyrë të hollësishme në këtë raport. Paneli ka shpallur 14 ankesa të tjera të papranueshme.

Paneli dhe Sekretariati kanë vazhduar fushatën informuese me qëllim të shpërndarjes së informacionit në lidhje me mandatin e tij, duke u përqendruar më së shumti në gjyqësorin e Kosovës, në OJQ-të që merren me të drejta të njeriut dhe ndihmë juridike, përfaqësues të shoqërisë civile si dhe në kisha dhe organe fetare në Kosovë dhe Serbi. Paneli dhe Sekretariati gjithashtu kanë marrë pjesë në intervista në media dhe debate dhe kanë marrë pjesë në seminare të ndryshëm për të drejtat e njeriut, konferenca dhe tryeza të rrumbullakëta.

Paneli gjithashtu ka vazhduar me takimet e tij periodike me shefin e Misionit, zëvendës shefin e Misionit dhe zyrtarë të tjerë të lartë të EULEX-it. Në këtë aspekt, Paneli iu ka bërë një prezantim rreth mandatit, procedurave dhe jurisprudencës së vet prokurorëve të EULEX-it dhe zyrtarëve ligjorë në qershor të vitit 2013.

Sekretariati po ashtu ka zhvilluar aktivitete rreth fushatës informuese në Serbi, ku ka mbajtur takime me projektin "Përkrahje e mëtutjeshme për zbatimin e Strategjive për personat e zhvendosur brenda vendit (PZhBV), refugjatë dhe të kthyer - ndihmë juridike", financuar nga Delegacioni i Bashkimit Evropian në Serbi.

Një buletin i rregullt elektronik, i cili ka filluar në vitin 2012, ka dëshmuar të jetë mjeti më i suksesshëm në ofrimin e informacionit mbi Panelin dhe në ngritjen e vetëdijesimit publik për mandatin dhe operacionet e tij. Megjithatë, pavarësisht nga aktivitetet e tij të gjera në terren,

vazhdon të ketë mungesë të theksuar të njohjes së ekzistencës të Panelit dhe mandatit në zonën ku vepron misioni.

Paneli beson se ky boshllëk mund të trajtohet vetëm me një fushatë përmes TV-së/radio-së, që shpresohet të nisë më në fund në vitin 2014, së bashku me një intensifikim të aktiviteteve të tij të rregullta të fushatës informuese në vazhdim e sipër. Megjithatë, kjo do të kërkojë që për këtë qëllim të caktohen burime të duhura financiare nga EULEX-i.

Gjatë periudhës raportuese ka pasur disa ndryshime në përbërjen e Panelit, me dorëheqjen e anëtares së Panelit znj. Verginia Micheva-Ruseva, e cila është zëvendësuar nga ish-anëtarja zëvendësuese znj. Katja Dominik. Znj. Elka Filcheva-Ermenkova është emëruar anëtare e re zëvendësuese e Panelit.

Dëshiroj të shfrytëzohet kështu mundësi të shpreh falënderimin tim për të gjithë anëtarët e mëhershëm dhe të tanishëm të Panelit dhe të Sekretariatit për kontributin e tyre të jashtëzakonshëm profesional në punën e Panelit gjatë periudhës raportuese.

Njësoj, dëshiroj të shpreh falënderimin tim për shefin e Misionit të EULEX-it dhe personelin e tij si dhe për shefin e zyrës ligjore dhe të drejta të njeriut të EULEX-it dhe për EULEX-in në përgjithësi për mbështetjen dhe bashkëpunimin e tyre gjatë gjithë vitit me Panelin dhe Sekretariatin.

Më në fund, Paneli për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut do të donte që ta përshëndes veprimin e shefit të Misionit në zbatimin e rekomandimeve të tij në lëndët e tij gjatë periudhës së raportimit. Në veçanti, Paneli do të donte të përgëzojë shefin e Misionit për veprimet e tij pasuese korrigjuese në lidhje me rekomandimet e tij në lëndët [A, B, C & D kundër EULEX-it](#), (Lënda nr. 2012-09/10/11/12), *“lëndët e Vidovdanit”*.

Magda Mierzevska
Kryesuese
Paneli për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut

1. Hyrje

Paneli për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut, i themeluar nga Bashkimi Evropian më 29 tetor 2009 ka vazhduar me shqyrtimin e shkeljeve të dyshuara të të drejtave të njeriut nga ana e EULEX-it në Kosovë gjatë ushtrimit të mandatit të tij ekzekutiv në tërë vitin e tretë të operacioneve për vitin 2013. Paneli është veçanërisht i pari dhe deri më tani mekanizmi i vetëm llogaridhënës i të drejtave të njeriut që merret me shkeljet e pohuara të të drejtave të njeriut nga një mision i Sigurimit të Përbashkët dhe Politikës së Mbrojtjes të Bashkimit Evropian.

Tani së bashku me Panelin Këshillëdhënës për të Drejtat e Njeriut të Misionit të Kombeve të Bashkuara të Administratës së Përkohshme në Kosovë (UNMIK), Paneli shërben si një nga vetëm dy Panelet që mbajnë organizatat ndërkombëtare përgjegjëse për shkeljet e të drejtave të njeriut. Zgjerimi i llogaridhënies për shkeljet e të drejtave të njeriut prej shteteve deri tek organizatat ndërkombëtare paraqet një përparim të madh në zhvillimin e mbrojtjes ndërkombëtare të të drejtave të njeriut që gjen njohje ndërkombëtare në rritje e sipër.

Raporti përshkruan veprimtaritë e Panelit për periudhën 1 janar deri më 31 dhjetor 2013. Ky raport përqendrohet kryesisht në numrin e lëndëve të Panelit dhe jurisprudencën që është në zhvillim e sipër. Më tej, përpjekjet e Panelit në lidhje me aktivitetet e veta në terren e po ashtu edhe njohja e aktiviteteve të tij që është në rritje e sipër janë përshkruar në kontekst ndërkombëtar.

Gjatë periudhës raportuese, Paneli ka mbajtur [pesë seanca](#) dhe ka pranuar 27 ankesa të reja. Paneli ka shqyrtuar 35 lëndë, ndërsa 17 lëndë ia ka komunikuar shefit të Misionit. Paneli ka gjetur 13 lëndë të papranueshme, pesë lëndë të pranueshme dhe ka gjetur se ka pasur shkelje të të drejtave të njeriut në lidhje me shtatë ankues.

Këto lëndë shënojnë zhvillimet më të rëndësishme në jurisprudencën të Panelit, duke adresuar çështje kritike ligjore dhe faktike në lidhje me interpretimin e mandatit ekzekutiv të EULEX-it dhe detyrimet përkatëse të drejtave të njeriut që iu kanë dhënë Misionit.

Paneli i ka dorëzuar shefit të Misionit të EULEX-it në Kosovës rekomandime të hollësishme për t'i korrigjuar këto shkelje të të drejtave të njeriut. Paneli gjithashtu ka vlerësuar veprimet e shefit të Misionit pas përgjigjes ndaj rekomandimeve të ndryshme aty ku ka ndodhur ato shkelje të të drejtave të njeriut.

Paneli vlerëson veprimet e ndërmarra nga shefi i Misionit, në veçanti në lidhje me "lëndët e Vidovdanit", përkatësisht A, B, C dhe D, 2012/10/11/12. Paneli gjithashtu dëshiron të falënderoj dhe të përgëzoj kryeprokurorin e EULEX-it në Kosovë për shqyrtimin e lëndëve në fjalë: B, C dhe D në përputhje me rekomandimet e veta.

Në përfundim të vitit të katërt të punës, Paneli është i kënaqur që ka dhënë një kontribut të rëndësishëm në statusin ndërkombëtar, të cilin tani EULEX-i e gëzon nga pikëpamja e të drejtave të njeriut, si Mision i Politikës së Përbashkët për Mbrojtje dhe Siguri, ku vetë i nënshtrohet llogaridhënës së jashtme për shkeljet e pohuara të të drejtave të njeriut gjatë ushtrimit të mandatit të tij ekzekutiv.

2. Korniza rregulluese

2.1. Veprimi i përbashkët i Këshillit 2008/124/CFSP i datës 4 shkurt 2008 lidhur me Misionin Evropian për Sundimin e Ligjit në Kosovë, EULEX-i KOSOVË.

Veprimi i Përbashkët i Këshillit është burim i autoritetit dhe kompetencës së misionit të EULEX-it në Kosovë. Ai përcakton mandatin e EULEX-it, dhe ndër të tjera saktëson llogaridhënien e tij lidhur me të drejtat e njeriut në nenin 3 (i): *“të sigurojnë që të gjitha aktivitetet e tij respektojnë standardet ndërkombëtare lidhur me të drejtat e njeriut dhe barazinë gjinore”*.

2.2. Koncepti llogaridhënës i EULEX-it në Kosovë – Paneli për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut, Sekretariati i Përgjithshëm i Këshillit, Bruksel, i datës 29 tetor 2009

Krijimi i një mekanizmi efektiv dhe transparent i të drejtave të njeriut është cilësuar të jetë një nevojë thelbësore për EULEX-in në Kosovë, si Mision për Sundimin e ligjit, të cilit ju janë dhënë disa funksione të kufizuara ekzekutive. Një mekanizëm i tillë i jashtëm llogaridhënës do të shërbej për të plotësuar llogaridhënien e përgjithshme të EULEX-it në Kosovë, siç ofrohet nga Polica e Sigurimeve të Përgjegjësishë ndaj Palës së Tretë dhe nga Njësia e Hetimeve të Brendshme të EULEX-it në Kosovë, të cilat janë themeluar që në fillim.

Në këtë mënyrë, Koncepti llogaridhënës përcakton mandatin e Panelit për të shqyrtuar ankesat nga secili person, i cili pretendon se është viktimë e shkeljes së të drejtave të njeriut nga ana e EULEX-it në Kosovë gjatë kryerjes së mandat ekzekutiv të EULEX-it në Kosovë¹. Sidoqoftë, sipas këtij Koncepti, Paneli nuk ka juridiksion sa i përket gjykatave të Kosovës. Për më tepër, Paneli kanë gjetur se fakti që gjykatësit e EULEX-it ulen në trupin gjykues nuk e ndryshon karakterin e këtyre gjykatave, si gjykata të Kosovës (për më shumë hollësi shih par. 5.2.1 më poshtë).

Paneli ka miratuar Rregulloren e vet të Punës me datën 10 qershor 2010, prej kur edhe është autorizuar të pranoj ankesa.

2.3. Instrumentet e zbatueshme ndërkombëtare të të drejtave të njeriut

Sipas dispozitave të Konceptit llogaridhënës, Paneli mund të shqyrtoj ankesat që kanë të bëjnë me shkeljet e dyshuara, ndër të tjera, të këtyre instrumenteve të të drejtave të njeriut:

- Deklarata e Përgjithshme për të Drejtat e Njeriut (1948);
- Konventa Evropiane për mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore (KEDNj, 1950);
- Konventa për Eliminimin e të gjitha formave të Diskriminimit Racor (KEDR, 1965);
- Konventa Ndërkombëtare për të drejtat civile dhe politike (KDCP, 1966);
- Konventa Ndërkombëtare për të drejtat ekonomike, shoqërore dhe kulturore (KDEShK, 1966);
- Konventa për Eliminimin e të gjitha formave të Diskriminimit ndaj Gruas (KEDG, 1979);
- Konventa kundër Torturës dhe Trajtimeve e Ndëshkimeve të tjera Mizore, Jonjerëzore dhe Poshtëruese (KKT, 1984);
- Konventa Ndërkombëtare mbi të drejtat e Fëmijës (KDF, 1989).

¹ Koncepti llogaridhënës është pjesë e planit operativ të EULEX-it. Për këtë arsye konsiderohet një dokument i kufizuar dhe kështu nuk është i hapur për publikun.

Në praktikë, ankesat e parashtruara deri më sot kryesisht janë bazuar në nenet e Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNj) dhe Protokollet e saj.

3. Paneli dhe Sekretariati

3.1. E përgjithshme

Gjatë periudhës raportuese ka pasur disa ndryshime në përbërjen e Panelit. Znj. Verginia Micheva-Ruseva ka dhenë dorëheqje, e cila është zëvendësua nga ish-anëtarja e saj zëvendësuese, znj. Katja Dominik. Kurse ajo është zëvendësuar nga znj. Elka Filcheva-Ermenkova anëtare e re zëvendësuese e Panelit.

3.2. Anëtarët e Panelit – Të dhëna biografike

Paneli përbëhet prej tre anëtarëve, përfshirë kryesuesen dhe një anëtar zëvendësues të EULEX-it.

Kryesuesja e Panelit, znj. Magda Mierzevska, shtetase e Polonisë, ka kaluar me sukses Provimin Shtetëror të Polonisë për poste gjyqësore në vitin 1982. Ajo u pranua në Odën e Këshilltarëve Juridik të Gdanskut në vitin 1989 dhe ka arritur shkallën e magjistrisë të drejtësisë (LLM) në të Drejtën e Bashkimit Evropian në Universitetin Leicester në vitin 2005.

Ajo u emërua juriste rreth lëndëve në Sekretariatit e Komisionit Evropian për të Drejtat e Njeriut në Strasburg në vitin 1993. Pastaj, nga viti 1998 ajo ishte punësuar si juriste në Sekretariatit e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut në Strasburg, Francë. Ajo ka përvojë të gjerë ndërkombëtare të trajnimit në çështje të ndryshme thelbësore dhe procedurale të të drejtave të njeriut.

Publikimet e shumta akademike të znj. Mierzevska përfshijnë: *Konventa Evropiane për të Drejtat dhe Liritë Themelore të Njeriut: Dhjetë vite pas Ratifikimit, Zyra për Informim e Këshillit të Evropës në Varshavë, 2004; Dhjetë vjet më pas: Popullariteti i Konventës në Poloni (bashkë-autore), Revista e Ligjeve Evropiane për të Drejtat e Njeriut, botimi i 4, 2004; Dhjetë vjet më pas: Praktika gjyqësore polake voluminoze dhe interesante (bashkë-autore), Revista e Ligjeve Evropiane për të Drejtat e Njeriut, botimi 5, 2004; Standardet e përcaktuara në praktikën gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut në rastet lidhur me shpronësimet dhe aplikimin e tyre për kërkesat pronësore gjermane, Instituti Polak për Marrëdhënie ndërkombëtare, 2005; Procesi i pranimit të Konventës Evropiane për mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut në Poloni dhe Sllovakia në: Pranimi i Konventës Evropiane për mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut, botimet. H. Keller, A. Stone-Sweet, Oxford University Press, maj 2008; Konsistenca e praktikës gjyqësore si çështje e të drejtave të njeriut në jurisprudencën e Gjykatës evropiane të të drejtave të njeriut, në: *Cohérence et impact de la jurisprudence de la Cour européenne des droits de l'homme*, Liber amicorum Vincent Berger, 2013.*

Anëtarët

Dr. Guenael Mettraux

Dr. Mettraux punon avokat dhe konsulent pranë gjykatave penale ndërkombëtare (ICTY, ICC, STL dhe ECCC). Gjatë dhjetëvjeçarit të kaluar, ai ka përfaqësuar disa udhëheqës të lartë ushtarak dhe civil, të akuzuar për krime ndërkombëtare. Ai ka këshilluar qeveri dhe OJQ rreth çështjeve të ndryshme lidhur me regjimet rregullatore, gjykimet penale, ligjet dhe drejtësinë tranzicionale. Dr. Mettraux tani është profesor në Universitetin e Amsterdimit (Holandë) dhe ligjërues mysafir në Universitetin e Friburgut në Zvicër.

Ai ka bërë publikime të shumta në fushën e së drejtës ndërkombëtare. Puna e tij shkencore përfshinë tri libra: *International Crimes and the ad hoc Tribunals* (Krimet Ndërkombëtare dhe Tribunalet ad hoc) (Oxford University Press, 2005), *Perspectives on the Nuremberg Trial* (Perspektiva

rreth Gjykimit të Nyrembergut) (Oxford University Press, 2008) dhe The Law of Command Responsibility (Ligji mbi përgjegjësinë komanduese) (Oxford University Press, 2009), e cila ka marrë çmimin Lieber nga American Society of International Law (Shoqata Amerikane e së Drejtës Ndërkombëtare). Dr. Mettraux-i është anëtar i Komisionit Redaktues të Revistës të së Drejtës Ndërkombëtare dhe i Këshillit Redaktues të Revistës të së Drejtës Penale Ndërkombëtare.

Znj. Katja Dominik

Znj. Katja Dominik, shtetase e Gjermanisë, ka studiuar drejtësinë dhe gjuhët sllave në Universitetin e Goettingen-it në Gjermani, ku ka diplomuar në vitin 1996.

Znj. Domenik ju është dhënë bursë pasdiplomike, ku ka përfunduar studimet rreth aspekteve ligjore të shpërbërjes së shtetit të ish Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë në Zagreb, Kroaci në vitin 1998/99. Disertacioni i saj ishte botuar në vitin 2001.

Nga viti 2000 deri në vitin 2002 ajo ka punuar si nëpunëse ligjore në Gjykatën e Lartë Rajonale në Dyseldorf dhe gjithashtu në zyrën e avokatisë, e specializuar në ligjin për azil. Në vitin 2002 ajo u punësua nga Ministria Federale Gjermane e Bashkëpunimit dhe Zhvillimit Ekonomik në Bon, ku ishte punuar në Divizionin për politikë zhvillimore evropiane. Në këtë cilësi, ajo ka hulumtuar dhe përpiluar tekste dhe fjalime për konferenca ndërkombëtare për ndihmë zhvillimore në Bruksel dhe Bon, ku ajo gjithashtu në disa raste ka përfaqësuar qeverinë gjermane.

Në tetor të vitit 2002, znj. Domenik është emëruar gjykatëse në Gjykatën e Qarkut në Dyseldorf, ku është specializuar në lloje të ndryshme të ligjit penal. Më pas, ajo ishte bërë zëvendëse kryetare në dhomën penale të Gjykatës së Qarkut për krime të rënda kapitale dhe krime ekonomike.

Znj. Dominik është emëruar gjykatëse ndërkombëtare në EULEX në Kosovë në tetor të vitit 2011, ku më pas ajo është caktuar në Gjykatën e Qarkut të Mitrovicës, ku merret me raste të krimeve të luftës të një profili të lartë, vrasje, korrupsion dhe trafikim të qenieve njerëzore. Shefi i misionit të EULEX-it ka emëruar znj. Domenik anëtare të Panelit për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut të Bashkimit Evropian në janar të vitit 2013.

Anëtarja zëvendësuese

Znj. Elka Filcheva-Ermenkova

Znj. Elka Filcheva-Ermenkova, shtetase bullgare ka studiuar për drejtësi në Universitetin e Blagoevgrad-it, Bullgari ku ka diplomuar në vitin 1997. Ajo është përqendruar në studimet e të drejtave të njeriut gjatë shkallës së masterit dhe më vonë ka përfunduar kurse të shumta lidhur me Konventën Evropiane të të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore të Njeriut (KEDNJ) dhe Protokollet e saj. Pas përfundimit të stazhit të saj pas-universitar, në tetor 1998 ajo është emëruar gjykatëse e re në Gjykatën e Qarkut, Blagoevgrad në një panel të ankimit, ku nën mbikëqyrjen e dy gjyqtarëve të Gjykatës së Qarkut ajo ka kryesuar lëndë në të gjitha prej këtyre çështjeve: civile, të së drejtës penale dhe administrative. Në vitin 2001 ajo është emërua gjykatëse në Gjykatën Rajonale të Ligjit në Blagoevgrad ku ka kryesuar çështjet civile dhe penale. Në vitin 2003 ajo është emëruar kryetare e Gjykatës Rajonale në Blagoevgrad.

Në vitin 2004, ajo është emëruar gjykatëse e Gjykatës së Qarkut në shkallën e dytë, dhe ajo ka punuar edhe si gjykatëse e shkallës së parë dhe gjykatëse e apelit në çështjet civile dhe penale, me theks kryesor në çështjet civile.

Në janar të vitit 2008, ajo është dërguar në Këshillin e Bashkimit Evropian (BE), në departamentin për Planifikim Civil dhe Mundësi Operacionale (PCMO) si këshilltare për sundim të ligjit, ku ka punuar deri në janar të vitit 2012. Në janar 2012 ajo është emëruar gjykatëse ndërkombëtare në Komisionin për ankesa për ankesat kundër vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës. Ajo është emëruar zëvendëse anëtare e Panelit për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut të Bashkimit Evropian nga shefi i Misionit të EULEX-it më 15 janar 2013.

3.3. Sekretariati – Të dhëna biografike

Sekretariati i Panelit përbëhet prej një zyrtari të lartë ligjor, dy zyrtarë ligjor, një asistente administrative/gjuhësore dhe dy interpret/përkthyes.

Z. John J. Ryan, shtetas i Irlandës, ka diplomuar për Drejtësi me titullin Bachelor (Hons) në Drejtësi dhe Studime Evropiane nga Universiteti i Limerick-it, Irlandë, dhe ka diplomë pasuniversitare si avokat nga Shoqata e Avokatëve të Irlandës. Ai ka punuar si avokat me Stephen MacKenzie dhe Co. Solicitors, në Dublin, Irlandë. Ai ka shërbyer në Kombet e Bashkuara në Liban, Siri, Izrael, Kamboxhia, Bosnje dhe Hercegovinë, Kroaci, Maqedoni, Timorin lindor, Nepal, Kosovë dhe në Komisionin Evropian në Kinë. Para se të merrte detyrën e tij të tanishme ai kishte punuar në UNMIK, ndër të tjera si administrator në Komunën e Zveçanit në regjionin e Mitrovicës, shef i Divizionit për Mbështetje Gjyqësore Ndërkombëtare-Departamenti i Drejtësisë, këshilltar ligjor, Zyra e Përfaqësuesit të Posaçëm të Kombeve të Bashkuara (O/PSSP) - UNMIK, dhe zyrtar ekzekutiv, Paneli Këshillëdhënës i të Drejtave të Njeriut të UNMIK-ut. Ai është emëruar zyrtar i lartë ligjor dhe shef i Sekretariatit të Paneli në prill 2010. Artikulli i tij rreth Panelit Këshillëdhënës për të Drejtat e Njeriut të Misionit të Kombeve të Bashkuara në Kosovë është botuar në Revistën e Forcave të Mbrojtjes së Irlandës në vitin 2010.

Znj. Joanna Marszalik, shtetase e Polonisë, ka diplomuar për Drejtësi në nivelin master nga Universiteti i Jagiellonian-it në Krakow, Poloni. Për pesë vite ajo ka punuar juriste në Gjykatën Evropiane të të Drejtave të Njeriut në Strasburg, Francë. Më pas ajo ishte menaxhere e projektit për Këshillin e institutit të Evropës në projektin ndërtues institucional “Mbështetja për Institucionin e Avokatit të Popullit në Kosovë” dhe udhëheqëse ekipi e këshillit të Evropës dhe projektit të Bashkimit Evropian “Transparenca dhe Efikasiteti i Sistemit Juridik në Ukrainë”, e cila ka mbështetur reformat e sistemit juridik të Ukrainës. Ajo ju bashkua misionit të OSBE-së në Kosovë në dhjetor të vitit 2010, ku punoj si zyrtare e lartë e të drejtave të njeriut, duke mbikëqyrur Qendrën Rajonale në Prishtinë. Ajo u emërua si zyrtare ligjore në Sekretariatit të Panelit në prill të vitit 2012.

Z. Florian Razesberger, shtetas i Austrisë, ka studiuar për juridik në Universitetin e Vjenës, Kopenhagës dhe Innsbruck-ut (shkalla e masterit në vitin 2001, shkalla e doktoratës në vitin 2005). Ai fillimisht ka punuar si nëpunës ligjor në Gjykatën Rajonale të Innsbruck-ut dhe është emëruar asistent zyrtar ligjor brenda Presidencës dhe Dhomës së Gjykatës Penale Ndërkombëtare në Hagë. Më pastaj, ai u emërua këshilltar ligjor në OJQ-në britanike për ndihmë ligjore “Africa Middle East Refugee Assistance” në Kairo, Egjipt. Më pas, ai është emëruar zyrtar ligjor në sektorin për reformë gjyqësore dhe të drejta të njeriut në misionin e OSBE-së në Shkup dhe Sarajevë (ku ka punuar për 5 vite). Më pas, ai u emërua zyrtar për të drejtat e njeriut dhe udhëheqës ekipi për misionin e asistencës së Kombeve të Bashkuara në Afganistan. Ai ka punuar si ekspert i të drejtave të njeriut në EULEX para se t’i bashkohej Sekretariatit të PShDNj-së.

Znj. Shpresa Gosalci, shqiptare e Kosovës, ka diplomuar në Universitetin AAB, Prishtinë, në degën e gjuhës dhe letërsisë angleze. Ajo ishte punësuar si përkthyes (shqip/serbisht/anglisht) në KFOR nga korriku i vitit 1999 deri në qershor të vitit 2000, si dhe si asistente administrative/gjuhësore në Zyrën e Informimit Publik dhe Media të Komisionarit të Policisë së UNMIK-ut nga qershori i vitit 2000 deri

në mars të vitit 2009. Ajo është asistente administrative/gjuhësore në Sekretariatit e Panelit që nga korriku i vitit 2010.


Znj. Katica Kovaçević, serbe e Kosovës, ka qenë e punësuar më parë si asistente administrative/gjuhësore (serbisht/anglisht) në Zyrën e Auditorit të Përgjithshëm nga maji i vitit 2003 deri në dhjetor të vitit 2008 dhe si asistente gjuhësore në Agjencinë Kosovare të Privatizimit nga janari i vitit 2009 deri në nëntor të vitit 2010. Ajo filloj punën si interprete/përkthyes në Sekretariatit e Panelit në dhjetor të vitit 2010.

Z. Kushtrim Xhaferi, shqiptar i Kosovës, ka diplomuar në Universitetin e Prishtinës, Kosovë, në degën e gjuhës dhe letërsisë angleze. Ai më parë ka punuar si interpret/përkthyes (shqip/anglisht) në Korporatën Energjetike të Kosovës nga shkurti i vitit 2004 deri në janar të vitit 2009, dhe më pas si asistent gjuhësor në Komponentin e Policisë së EULEX-it. Ai punon si interpret/përkthyes në Sekretariat që nga shtatori i vitit 2010.


4. Numri i lëndëve dhe subjekti i ankesave

4.1. Numri i lëndëve dhe statistikat

Në 2013, Paneli ka shqyrtuar 35 lëndë, ka komunikuar 17 lëndë tek shefi i Misionit me kërkesat për vërejtje mbi pranueshmërinë dhe bazueshmërinë e tyre dhe ka marrë 21 vendime. Për ndryshim nga vitet e mëparshme, Paneli ka konstatuar një numër të shkeljeve të të drejtave të njeriut. Në katër vendimet që kishin të bënin me gjithsej shtatë ankesa, Paneli ka konstatuar shkelje të neneve 8, 9, 11 dhe 13 të KEDNj-së. 14 lëndë janë shpallur të papranueshme. Kjo ka përfshirë një lëndë në të cilin Paneli për herë të parë ka ri shqyrtuar ndonjë ankesë.



Gjatë vitit 2013, në Panel janë regjistruar 27 lëndë të reja, e që arrin në një rritje prej 13% krahasuar me vitin e kaluar. Që nga fillimi i tij, Paneli ka parë një rritje të ngadaltë, por të qëndrueshëm të numrit të lëndëve. Deri në fund të vitit 2013, në Panel janë parashtruar gjithsej 94 lëndë, nga të cilat 63 janë mbyllur.



4.2. Trendët

Përderisa disa ankesa kanë të bëjnë me shkeljet e pohuara të të drejtave nga ana e EULEX-it që rezultojnë prej veprimeve të Misionit, shumica e shkeljeve të dyshuara thuhet se janë rezultat i gjoja dështimit të EULEX-it për të vepruar. Ankesat e tilla janë të lidhura në mënyrë të veçantë me refuzimin e dyshuar të prokurorisë për të filluar hetimet dhe/ose dështimin për të ngritur padi, si

dhe akuzat se policia e EULEX-it nuk ka ndërmarrë masa të arsyeshme për të mbrojtur ankuesit nga rreziku që vjen prej palës së tretë.

4.3. Subjekti i ankesave

Llojet më të shpeshta të shkeljeve të dyshuara të të drejtave të njeriut të parashtruara në Panel janë si në vijim:

- Akuzat për shkelje të së drejtës për jetë (neni 2 KEDNj): lëndët e *Y kundër EULEX-it*, nr. 2011-28; *Faik Ibishi kundër EULEX-it* nr. 2012-07; *E kundër EULEX-it* nr. 2012-17;
- Akuzat për shkelje të parandalimit të torturës ose dënimeve apo trajtimeve çnjerëzore ose poshtëruese (Neni 3 i KEDNj, Neni 6 paragrafi 1 dhe 2 i Konventës Evropiane të Kombeve të Bashkuara kundër torturës ose dënimeve apo trajtimeve çnjerëzore ose poshtëruese): lëndët *W kundër EULEX-it*, nr. 2011-07; *F kundër EULEX-it*, nr. 2011-27; *Z kundër EULEX-it*, nr. 2012-6; *Mufail Halili kundër EULEX-it* nr. 2012-08; *Arsim Krasniqi kundër EULEX-it*, nr. 2013-02; *Almir Susaj kundër EULEX-it*, nr. 2013-16;
- Akuzat për shkelje të së drejtës për liri dhe siguri personale (Neni 5, paragrafi 1c, 2, 3 dhe 4 KEDNj, Neni 9, paragrafi 2 deri 4 i Konventës ndërkombëtare mbi të drejtat civile dhe politike): lëndët *Z kundër EULEX-it*, nr. 2012-12; *E kundër EULEX-it*, nr. 2012-17;
- Akuzat për shkelje të së drejtës për gjykim të drejtë (Neni 6 i KEDNj): lëndët e *Faik Ibishi kundër EULEX-it* nr. 2012-07; *Z kundër EULEX-it*, nr. 2012-06; *Mufail Halili kundër EULEX-it* nr. 2012-08;
- Akuzat për shkelje të së drejtës për gjykim të drejtë (Neni 6 i KEDNj) në lidhje me një shkelje të gëzimit paqësor të një pronësie, Neni 1 i protokollit Nr. 1 të KEDNj: lëndët *Shaip Gashi kundër EULEX-it*, nr. 2011-25; *Shefqet Emërllahu kundër EULEX-it* nr. 2012-15; *Kristian Kahrs kundër EULEX-it*, nr. 2012-16;
- Akuzat për shkelje të së drejtës së respektimit të jetës private dhe familjare (Neni 8 i KEDNj): lënda: *W kundër EULEX-it*, nr. 2011-07;
- Akuzat për shkelje të së drejtës së lirisë së mendimit, ndërgjegjes dhe fesë, (Neni 9 i KEDNj), e drejta e lirisë së shprehjes, (Neni 10 i KEDNj) dhe e drejta e lirisë së tubimit dhe organizimit (Neni 11 i KEDNj): *A. kundër EULEX-it*, nr. 2012-09; *B. kundër EULEX-it*, nr. 2012-10; *C. kundër EULEX-it*, nr. 2012-11; *D. kundër EULEX-it*, nr. 2012-12; *H kundër EULEX-it* nr. 2012-19; *G kundër EULEX-it* 2012-20;
- Akuzat për shkelje të së drejtës për zgjidhje efektive (Neni 13 i KEDNj) në lidhje me
 - Neni 6: *Z kundër EULEX-it*, nr. 2012-06; *Faik Ibishi kundër EULEX-it* nr. 2012-07
 - Neni 8: *Valbone Zahiti kundër EULEX-it*, nr. 2012-14
 - Neni 8, 9, 10 dhe 11: *A. kundër EULEX-it*, nr. 2012-09; *B. kundër EULEX-it*, nr. 2012-10; *C. kundër EULEX-it*, nr. 2012-11; *D. kundër EULEX-it*, nr. 2012-12; *H kundër EULEX-it* nr. 2012-19; *G kundër EULEX-it* 2012-20;
- Akuzat për shkelje të së drejtës për gëzim paqësor të pasurisë (Neni 1 i Protokollit 1 të KEDNj): *Kahrs kundër EULEX-it*, nr. 2012-16;

Ankuesit ju kanë drejtuar një numri të instrumenteve të tjera ndërkombëtare të të drejtave të njeriut:

Konventa Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike

Ankuesit ndër të tjera iu drejtohen neneve 2, 5, 6, 7, 9, 14, 16, 17, 18, 19, 21, 22, 23, 25, 26, 27 të Konventës Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike (ICCPR).

Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut

Nenet 1, 2, 7, 8, 10, 11, 12, 17, 28 dhe 29 të Deklaratës Universale të të Drejtave të Njeriut po ashtu janë përmendur.

Konventa kundër Torturës dhe Trajtimeve apo Dënimeve të tjera mizore, çnjerëzore apo poshtëruese

Ankuesit iu kanë drejtuar në përgjithësi Konventës kundër Torturës.

Konventa për Eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit racor

Neni 1, paragrafi 1 dhe 2, Neni 2, paragrafi 1, pika a, b, c, Neni 5, pika a dhe b, dhe Neni 6 i Konventës për Eliminimin e të gjitha Formave të Diskriminimit Racor (CERD) kanë qenë të përmendura për herë të parë.

5. Jurisprudenca

Siç është përmendur më lartë, viti 2013 kishte pasur numrin më të madh të shkeljeve të të drejtave të njeriut që ndonjëherë është konstatuar nga Paneli brenda një viti kalendarik.

5.1. Meritat

Shkeljet e të drejtave të njeriut nga EULEX-i janë gjetur në lëndët si në vijim:

5.1.1. *W kundër EULEX-it* – zbulimi i informacionit lidhur me identitetin e dëshmitarit

Më 10 prill 2013, Paneli ka vendosur njëzëri se EULEX-i në Kosovë ka shkelur nenin 8 të KEDNJ, d.m.th. një të drejtë për respektimin e jetës private dhe familjare, në lëndën nr. 2011-07, [*W kundër EULEX-it*](#). Ankuesi ka pohuar se prokurorët e EULEX-it në Kosovë kishin dërguar deklaratën e tij prej dëshmitari dhe të dhënat personale tek autoritetet shtetërore në Serbi në kontekst të një hetimi për krimet e luftës. Paneli ka konstatuar se ka pasur arsytim jo të duhur dhe masa mbrojtëse jo të përshtatshme për zbulimin e të dhënave personale të ankuesit. Në mënyrë të veçantë nuk dukej se kishte bazë ligjore për veprimet e prokurorëve të EULEX-it dhe ankimet e ankuesit ndaj këtij zbulimi ishin shpërfillur. Si pasojë, kjo ia kishte mohuar ankuesit mundësinë për ta kontestuar atë në gjykatat vendore.

Paneli iu ka qasur çështjeve të “qëllimit legjitim”, “domosdoshmërisë” dhe “proporcionalitetit” të shkeljes së të drejtave të ankuesit. Paneli është i bindur se bashkëpunimi me autoritetet serbe ka ndjekur qëllimin legjitim të parandalimit të trazirave dhe të krimit sipas kuptimit të paragrafit 2 të nenit 8 të KEDNJ-së. Paneli ka theksuar se “*ky hetim dhe ndjekje penale e krimeve të luftës dhe krimeve të tjera ndërkombëtare është pa dyshim qëllim që duhet të ndiqet me të gjitha energjitë dhe të cilat, në disa rrethana mund të kërkojnë vendosjen e kufizimeve ndaj të drejtave të garantuara me nenin 8 të [KEDNJ-së]*”. Megjithatë, Paneli nuk është bindur se ishte arritur ekuilibër i drejtë në mes të jetës private të ankuesit dhe qëllimit legjitim të zhvillimit të një hetimi efektiv.

Paneli ka konstatuar se “*kjo është detyrë normale qytetare që individët të ofrojnë dëshmi në procedurë penale ([aktgjykim i Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut] Voskuil kundër Holandës nr. 64752/01, aktgjykimi i datës 22 nëntor 2007, par. 86)*”.

Megjithatë, përgjegjësia për të hetuar dhe ndjekur penalisht krimet serioze gjithashtu përfshinë përgjegjësitë që bien mbi autoritetet kompetente për të mbrojtur ata që iu ofrojnë atyre informacione. Interesat e dëshmitarëve në parim janë të mbrojtura nga dispozitat thelbësore të Konventës, të cilat nënkuptojnë se procedura penale duhet të organizohet në mënyrë të tillë që këto interesa nuk vihen në rrezik pa arsye. Ajo mund të nënkupton një detyrim pozitiv nga ana e autoriteteve për të marrë masa në mënyrë që të sigurojnë mbrojtjen dhe sigurinë e dëshmitarëve edhe pse ky detyrim nuk duhet të imponon mbi ta barrë të pamundur apo joproporcionale.

Duke pasur parasysh peshën e krimeve të dyshuara në lidhje me të cilat ankuesi kishte ofruar informacion, frika e vërtetë të cilën e kishte shprehur dhe mjedisin e paqëndrueshëm në të cilën ai jeton, Paneli ka vënë në dukje se prokurorët e EULEX-it kishte dijeni ose duhej të kishte dijeni se zbulimi i pakushtëzuar i deklaratës së tij së bashku me të dhënat e tij personale tek autoritetet serbe do të mund ta ekspozonte atë dhe familjen e tij ndaj dëmit të mundshëm.

Prokurorët e EULEX-it nuk kanë arritur të marrin masa brenda fushës së kompetencave të tyre të cilat do të mund të priten për të shmangur ose zvogëluar këtë rrezik (p.sh. ata mund të kishin fshirë

karakteristikat identifikuese të dëshmitarit ose të kërkonin masa mbrojtëse apo urdhra për t'u mos zbuluar nga autoritetet kompetente në Serbia para se t'ia dërgonin atyre deklaratën e tij).

Prandaj, Paneli ka konstatuar se prokurorët e EULEX-it nuk kishte marrë masa që në mënyrë të arsyeshme është pritur prej tyre në ato rrethana dhe potencialisht kanë ekspozuar ankuesin dhe familjen e tij ndaj rrezikut të paarsyeshëm. Nuk ka pasur as edhe tregues se EULEX-i kishte kryer ndonjë vlerësim të rrezikut për të përcaktuar se çfarë masash mund të arsyetoheshin në ato rrethana për të mbrojtur interesat e tyre. Paneli ka konkluduar se “në rrethanat e këtij rasti, qëllimi legjitim i dënimit të personave të dyshuar për kryerjen e krimeve të luftës nuk ishte arsye e mjaftueshme për të arsyetuar zbulimin e deklaratës së ankuesit dhe të dhënat personale pa pëlqimin e tij, pa një bazë të duhur ligjore, pa mbikëqyrja gjyqësore dhe pa masa mbrojtëse të ndërmarrë për të kufizuar rreziqet që dalin gjatë zbulimit të atij informacioni”.

Paneli gjithashtu ka rekomanduar që të ndërmerren një numër masash korrigjuese nga shefi i Misionit për t'iu qasur çështjeve në fjalë.

Vendimi pasues lidhur me rekomandimet e Panelit

Në [vendimin pasues](#) të Panelit lidhur me këtë lëndë që ishte miratuar më 27 nëntor 2013, Paneli ka konstatuar se shefi i Misionit të EULEX-it kishte zbatuar rekomandimet e Panelit vetëm pjesërisht. Përderisa disa prej rekomandimeve të Panelit janë zbatuar, është vërejtur se rekomandimi që prokurorët e EULEX-it duhet t'iu kërkonin homologëve të tyre serbë që t'i kthejnë apo asgjësojnë kopjet e dokumenteve, të cilat mbajnë emrin e ankuesit dhe që t'a asgjësojnë secilin informatë në dokumentet e tjera që mund ta identifikojë atë nuk ishte zbatuar. Më tej, nuk ishte kryer vlerësimi i mëvonshëm i rrezikut siç ishte rekomanduar nga Paneli. Paneli rrjedhimisht ka ftuar shefin e Misionit ta merr parasysh edhe një herë zbatimin e rekomandimeve të tij.

5.1.2. Lëndët e *Vidovdanit* – obligimi i EULEX-it për të mbrojtur të drejtat e njeriut

A, B, C & D kundër EULEX-it

Paneli ka deklaruar se [në katër lëndë](#) ka pasur shkelje të të drejtave të njeriut nga ana e EULEX-it gjatë ushtrimit të mandatit të tij ekzekutiv në lidhje me incidentet në katër rastet të cilat kanë ndodhur në *Vidovdan*, më 28 qershor 2012. Festa e *Vidovdanit* shënon një festë të rëndësishme fetare, ku mijëra serbë etnikë vizitojnë vendet përkujtimore në Kosovë, ku vendi kryesor është Gazimestani, vendndodhja e monumentit ku përkujtohet beteja e Fushës së Kosovës në vitin 1389.

Katër ankues kanë pohuar se kanë qenë objekt sulmesh nga palë private të pa identifikuar që *në mes tjerash* përfshinë hedhjen e gurëve dhe koktej molotovit drejt fëmijëve të vegjël serbë, të cilët udhëtonin me autobusë nga Gazimestani për në Graçanicë pas festimeve të *Vidovdanit*. Një ankues tjetër ka pohuar se ka qenë i sulmuar nga policia e Kosovës.

Paneli ka konstatuar se pamjaftueshmëria e mjeteve të ndara nga EULEX-i për operacionin e sigurisë në atë ditë kishte kontribuar që ankuesve t'iu mohohet gëzimi i plotë dhe efektiv i së drejtës së tyre për të respektuar jetën private, lirinë e tubimit, si dhe të drejtën e tyre për të ushtruar fenë e tyre në mënyrë të sigurt dhe pa pengesa të panevojshme. Paneli ka theksuar se “[ishte] pikërisht mungesa e policisë së EULEX-it në vendin e ngjarjes dhe mungesa e largpamësisë së nevojshme që kishte ngritur shqetësim.” Brenda kornizës së mandatit të tij ekzekutiv dhe në përputhje me disponueshmërinë e burimeve të saj, Paneli ishte i mendimit se “EULEX-i është dashur të sigurohet se një numër i mjaftueshëm i zyrtarëve policorë të EULEX-it të ishte caktuar për të vëzhguar ato ngjarje, që ata të vendosen në vendet kritike (p.sh. pikat e hyrjes administrative kufitare; rrugëve që çojnë drejt atyre

pikave dhe nga ato pika të hyrjes dhe në vendet e identifikuara të tubimit, si dhe në Gazimestan, etj.), dhe se t'i ketë të gjitha mjetet e nevojshme në dispozicion të tyre, për shembull, në aspektin e transportit dhe komunikimit, si dhe mjete për përmbarrim, për të kryer funksionet e tyre në mënyrë efektive dhe se ata t'i kenë marrë instruksione dhe udhëzime të qarta se kur dhe në çfarë rrethanash ata duhej dhe pritej të ndërhyjnë për të parandaluar shkeljet e të drejtave të njeriut, duke përfshirë parandalimin e frikësimit ose sjelljes agresive nga palët private.”

Për më tepër, Paneli ka konstatuar se EULEX-i nuk ka arritur të tregojë se kishte kryer një hetim të plotë dhe të përshtatshëm në shkeljet e pohuara të të drejtave të njeriut. Si rezultat, ankuesve iu ishte mohua mjete i përshtatshëm ligjor për shkeljen e të drejtave të tyre. Paneli gjithashtu ka rekomanduar që të ndërmerren një sërë masash korrigjuese nga shefi i Misionit për t'i adresuar çështjet e përfshira në këtë lëndë.

H & G kundër EULEX-it

Paneli ka deklaruar se ka pasur shkelje të të drejtave të njeriut nga EULEX-it në kryerjen e mandatit të tij ekzekutiv në lidhje me [dy lëndë të tjera](#) të cilat kanë ndodhur në *Vidovdan* më 28 qershor 2012.

Ankuesit, të cilët ishin pjesëmarrës në këto festime kanë pohuar se ishin ndaluar nga Policia e Kosovës në vendkalimin në *Merdare*. Policia e Kosovës kishte konfiskuar gjësendet e tyre që përfshijnë bluzat pa manga, të cilat mbanin simbole serbe dhe flamuj serb dhe iu kishin kërcënuar ankuesve.

Paneli kishte përcjellë arsyetimin e vendimeve të saj të mëparshme në lëndët që dalin nga festimet e *Vidovdanit* të vitit 2012, duke vënë në dukje obligimin e EULEX-it në kuadër të [Veprimit të përbashkët të Këshillit](#) për të siguruar që aktivitetet e tij duhet të bëhet në përputhje me standardet ndërkombëtare të të drejtave të njeriut.

Në këtë aspekt, Paneli ka theksuar “se EULEX-i nuk pritet të ofrojë punë më të mirë policore sesa që lejojnë burimet që i kanë në dispozicion. EULEX-i është i detyruar që, megjithatë të ndërmerr masat e nevojshme dhe të arsyeshme në kuadër të kompetencave të tij për të siguruar mbrojtjen efektive të të drejtave të njeriut të atyre që janë në territorin e Kosovës”.

Paneli ka konstatuar se “mungesa e largpamësisë së nevojshëm në lidhje me planifikimin e festimeve vjetore të Vidovdanit dhe si rezultat mungesa e numrit të mjaftueshëm të punonjësve të policisë së EULEX-it në vendngjarje shkakton shqetësim. Paneli ka vërejtur mungesën e dokumentacionit të hollësishëm operacional dhe mungesën e planifikimit emergjent. Mund të ishte parashikuar nga EULEX-i që pika e hyrjes në Merdare, si një nga pikat kryesore të kalimit, do të përdoret nga një numër i madh i pjesëmarrësve gjatë festimeve të Vidovdanit, të cilët hyjnë në Kosovë. Paneli ka konstatuar se EULEX-i ka ndarë burime të pamjaftueshme për të siguruar respektimin e të drejtave të njeriut nga autoritetet e Kosovës dhe palët e treta gjatë operacionit të sigurisë në Vidovdan. Më tej, Paneli ka theksuar se EULEX-i ka ofruar trajnim të pamjaftueshëm dhe udhëzime të pamjaftueshme operative personelit të vet, të cilët ishin caktuar aty atë ditë”.

Prandaj, e drejta e ankuesve në respektimin e jetës private, e drejta e tyre për lirinë e tubimit, si dhe e drejta e tyre për të ushtruar fenë e tyre nuk ishin të garantuara në mënyrë efektive dhe të mbrojtura nga EULEX-i gjatë kryerjes së misionit të tij. Paneli gjithashtu ka rekomanduar që të ndërmerren një sërë masash korrigjuese nga shefi i Misionit për ta adresuar çështjet në fjalë.

Paneli do të donte të përfitoj nga ky rast për të mirëpritur veprimet e ndërmarra nga shefi i Misionit i EULEX-it në Kosovë në miratimin e masave korrigjuese, të cilat i ka rekomanduar në vendimet e tij në

lëndët A, B, C & D kundër EULEX-it, si dhe në lëndët H & G kundër EULEX-it, “lëndët e Vidovdanit”. Paneli me kënaqësi vënë re se rekomandimet e veta me sa duket kanë shërbyer si udhërrëfyes për përgatitjen e festimeve të Vidovdanit në vitin 2013, që kishin shkuar mirë dhe nuk kishte pasur incidente të atij lloji që kishin nxitur ankesën lidhur me ngjarjet e vitit 2012.

5.2. Pranueshmëria

Në një numër të vendimeve Paneli ka adresuar çështje të ndryshme të rëndësishme lidhur me pranueshmërinë e ankesave pranë tij:

5.2.1. Kompetenca e Panelit për shqyrtimin e procedurave të gjykatave në Kosovë

Në një numër të vendimeve (p.sh. lëndët nr. 2012-06, Z kundër EULEX-it; Nr. 2012-17, E kundër EULEX-it), Paneli ka përsëritur qëndrimin e tij se në bazë të Rregullës 25, paragrafi 1 i Rregullores së Punës, bazuar në konceptin e llogaridhënies në OPLAN-it të EULEX-it në Kosovë, Paneli nuk ka juridiksion në lidhje me aspektet administrative apo gjyqësore të punës së gjykatave të Kosovës (shih 2.2 më lartë). Fakti që gjykatësit e EULEX-it ulen në trupin gjykues nuk e ndryshon karakterin e këtyre gjykatave si gjykata të Kosovës.

Në të njëjtat lëndë, Paneli ka mbështetur pikëpamjen e vet se veprimet e prokurorëve të EULEX-it të ndërmarra në kuadër të hetimit penal kanë qenë pjesë e mandatit ekzekutiv të EULEX-it në Kosovë dhe për këtë arsye kanë hyrë në kuadër të mandatit të Panelit. Veprimet apo mos veprimet nga prokurorët e EULEX-it gjatë fazës hetimore të procedurës penale nuk duhet të konsiderohen si pjesë përbërëse e “procedurave gjyqësore” për qëllimet e përcaktimit të kompetencës së Panelit. Pra veprimet e tyre i nënshtrohen autoritetit të Panelit, atëherë kur pretendohet se kanë ndodhur shkelje të të drejtave të njeriut.

Për më tepër, nuk mund të përjashtohet se Paneli mund të ketë kompetencë për të vlerësuar veprimet e prokurorëve të EULEX-it në hetimet penale edhe nëse ato i nënshtrohen shqyrtimit gjyqësor. Paneli do të kishte kompetencë për të shqyrtuar veprimet e tyre të cilat ngrehin çështje të të drejtave të njeriut. Paneli do të ndërhyjë vetëm në raste të tilla, megjithatë në qoftë se ankesat për shkelje të të drejtave të njeriut që i ngarkohen prokurorit nuk janë adresuar plotësisht nga autoritetet kompetente gjyqësore (të tilla si për shembull e drejta për liri personale dhe siguri brenda kuptimit të nenit 5 të KEDNj-së: shih par. 5.2.2 më poshtë, krahasoni dhe ballafaqoni me Z kundër EULEX-it, 2012-06, 10 prill 2013, në paragrafin 35).

5.2.2. Kompetenca e Panelit për të shqyrtuar ligjshmërinë dhe kohëzgjatjen e paraburgimit

Në lëndën Z kundër EULEX-it, Paneli ka konstatuar se nuk ka kompetencë për të shqyrtuar ankesat në lidhje me joligjshmërinë e pretenduar dhe zgjatjen e tepruar të paraburgimit të ankuesit. Është vërejtur se të gjitha vendimet lidhur me paraburgimin e ankuesit qoftë rreth zbatimit të tij ose më pas rreth zgjatjes së tij janë dhënë nga autoritetet gjyqësore. Këto vendime u ankimuan nga ankuesi dhe më pas u shqyrtohen nga gjykatat e apelit. Gjykatave iu ishte dhënë një mundësi për të shqyrtuar parashtrësat e ankuesit që kundërshtojnë ligjshmërinë e paraburgimit dhe vendime pasuese që zgjasin paraburgimin e tij. Rrjedhimisht, duke pasur parasysh faktin se paraburgimi i ankuesit ishte shqyrtuar nga gjykata dhe se ligjshmëria e tij ishte shqyrtuar më pas, pas ankimit nga ankuesi dhe nga gjykatat, Paneli nuk kishte kompetencë për shqyrtimin e mënyrës në të cilën ato gjykata kishin shqyrtuar ligjshmërinë e tyre.

5.2.3. Monitorimi, udhëzimi, këshillimi dhe mandati ekzekutiv i EULEX-it

Në një lëndë, ankuesi ka pohoi se Policia e EULEX-it që me sa duket që kanë vepruar në rolin e

“monitorimit, udhëzimit dhe këshillimit” (MUK) nuk i kishte mbrojtur të drejtat e tij të njeriut. Aktivitetet e MUK-së së EULEX-it iu ofrojnë mbështetje institucioneve të Kosovës, autoriteteve gjyqësore dhe agjencive të zbatimit të ligjit duke monitoruar, udhëzuar dhe këshilluar për të zhvilluar dhe për të forcuar sundimin e ligjit. Sa i përket mandatit ekzekutiv të EULEX-it dhe marrëdhënies me aktivitetet e MUK-së, Paneli ka vlerësuar se në çfarë mase aktivitetet e EULEX-it që nuk janë të lidhura me veprime tipike ekzekutive, megjithatë mund të hyjnë në kuadër të mandatit të tij ekzekutiv dhe të bëjnë që Paneli të ketë kompetencë. Paneli ka konstatuar *“se aktivitetet e MUK-it mund të bartin detyrim pozitiv për të ndërmarrë veprime, aty ku është e nevojshme ndërhyrja e menjëhershme në funksion të së drejtës së mbrojtur”* (shih Kahrs kundër EULEX-it, 2012-16, 10 prill 2013 në paragrafin 28). Paneli ka arsyetuar se *“duke pasur parasysh mandatin e kufizuar të EULEX-it, EULEX-i nuk mund të mbahet përgjegjës për dështimin që të garantoj mbrojtje efektive të të drejtave të njeriut si të tilla në Kosovë dhe se një barrë e pamundur apo jo-proporcionale sa i përket detyrave policore nuk mund t’i ngarkohet Misionit”*. Më tej, *“brenda kontekstit të MUK-it, obligimi që zyrtarët e EULEX-it të veprojnë për të parandaluar shkeljet e të drejtave të njeriut mund të thuhet se ngritet atëherë kur ata përballen me një kërcënim të ndonjë shkelje të drejtpërdrejtë dhe të rëndë të të drejtave individuale, pavarësisht nga subjekti i së drejtës në fjalë. Natyra e reagimit duhet të jenë e përshtatshme me rrethanat dhe nga ana tjetër varet se çfarë e drejte apo çfarë të drejta kanë qenë të rrezikuara dhe varet nga serioziteti i kërcënimeve të këtyre të drejtave”* (krahasoni Kahrs kundër EULEX-it, 2012-16, 10 prill 2013 në par. 31, ku Paneli ka konstatuar se policët e EULEX-it që veprojnë në cilësinë e MUK-it, në rrethanat rreth së cilave është ankuar, nuk ishin të detyruar të ndërhyjnë dhe vepronin në cilësinë e tyre korigjuese).

5.2.4. Statusi i viktimës

Në disa lëndë, Paneli kishte të bënte me pyetjen nëse ankuesi mund të pretendojnë të jenë viktimë e shkeljes së të drejtës së tij ose të saj. Paneli ka deklaruar se *“sipas kuptimit të fjalës “viktimë”, Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut (GjEDNj) ka gjetur në shumë raste se “viktimë” në kuptim të Konventës tregon personin e prekur drejtpërdrejt nga veprimi apo mosveprimi në atë çështje (shih, midis shumë autoriteteve, Amuur kundër Francës, 25 qershor 1996, § 36, Raportet e aktgjykimeve dhe vendimeve 1996 - III). Në disa raste, kur ka pasur një lidhje personale dhe të veçantë në mes të viktimës së drejtpërdrejtë dhe aplikuesit, Gjykata ka pranuar një kërkesë nga një person, i cili konsiderohej viktimë e tërthortë. Nëse një person është viktimë e tillë do të varet nga ekzistenca e faktorëve të veçantë që i japin vuajtjeve të aplikantit dimension dhe karakter të dallueshme nga shqetësimet emocionale që mund të konsiderohen se në mënyrë të pashmangshme iu është shkaktuar të afërmeve të viktimës së shkeljes së rëndë të të drejtave të njeriut. Elementet përkatëse do të përfshijnë, ndër të tjera, ekzistencën dhe afërsinë e lidhjes familjare, rrethanat e veçanta të marrëdhënies, masën në të cilën personi ka parë ngjarjet në fjalë, (shih, mutatis mutandis, Kurt kundër Turqisë, vendimi i datës 25 maj 1998, Raportet 1998-III, § § 130-134; Yaşa kundër Turqisë, vendim i datës 2 shtator 1998, Raportet mbi aktgjykimeve dhe vendimeve 1998-VI, § 71, dhe anasjelltas, Çakiçi kundër Turqisë [GC], nr. 23657/94, § § 98-99, ECHR 1999 - IV.”*

Në lëndën *Ibishi kundër EULEX-it* (nr. 2012-07), ankuesi ka pohuar se ishte në dijeni për ekzistencën e një rrjeti të gjerë dhe me ndikim të pedofilisë në Kosovë, që përfshinte banorë vendas dhe banorë ndërkombëtare, duke përfshirë personelin e EULEX-it. Paneli ka theksuar se *“Rregullat e tij të procedurës nuk parashikojnë sjelljen e një actio popularis; ato nuk lejojnë që individët të ankohen kundër veprimeve dhe mosveprimet të pretenduara nga ana e EULEX-it në abstracto thjesht sepse ata mendojnë se ato shkelin të drejtat e njeriut. Paneli ka vënë re se nuk ka ndonjë tregues se vetë ankuesi ka qenë ndonjëherë viktimë e aktiviteteve kriminale të rrjetit të dyshuar pedofil. Po ashtu nuk është treguar se ai ka ndonjë anëtar të familjes që ka qenë viktimë e unazës së pretenduar të pedofilisë. Prandaj, ai nuk mund të pretendojnë të jetë viktimë e drejtpërdrejtë apo jo e drejtpërdrejtë në çështjen në fjalë. Prandaj, refuzimi i dyshuar nga EULEX-i për të zhvilluar një hetim në veprimet e tyre nuk ndikon në asnjë mënyrë në të drejtat e ankuesit”*.

Në mënyrë të ngjashme, në lëndën nr. 2012-15, *Emërllahu kundër EULEX-it*, ku ankesa e ankuesit kishte të bënte me një dënim penal të një personi të tretë, Paneli ka konstatuar se ankuesi nuk kishte dhënë asnjë hollësi që do të konstatonte se marrëdhënia e tij me atë person ishte e afërt për ta konsideruar atë si viktimë të tërthortë të shkeljes së pretenduar.

5.2.5. Korrupsioni dhe të drejtat e njeriut

Në lëndën e *I kundër EULEX-it* që është marrë edhe me çështjen e statusit të viktimës, ankuesi ka sugjeruar se sjellja korruptive e supozuar e kryetarit ka rezultuar në shkelje të drejtpërdrejtë të të drejtave të njeriut të tij dhe qytetarëve të tjerë. Paneli ka konstatuar se *“në situata të caktuara korrupsioni mund në të vërtetë të arrijë ose të përbëjë kërcënim në gëzimin efektiv të të drejtave të njeriut. Paneli ka theksuar se korrupsioni, në masën që e minon sundimin e ligjit dhe besimin e qytetarëve në efektivitetin e sistemit ligjor, mund të përbëjnë pengesë për realizimin efektiv dhe gëzimin e të drejtave të njeriut”* (shih *I kundër EULEX-it*, 2013-01, 2013/11/25 në par. 19). Paneli nuk përjashton që sjellja korruptive e një zyrtari publik do të mund t'i japë statusin e viktimës një individ, të cilit iu është prekur e drejta e njeriut nga një sjellje e tillë. Megjithatë, në mënyrë që kjo të përbëjë rast, do të ishte e nevojshme për të krijuar një lidhje ndërmjet sjelljes së supozuar korruptive dhe pasojave të dëmshme në të drejtat e njeriut ndaj atij individ” (shih *I kundër EULEX-it*, 2013-01, 2013/11/25 në par. 21). Në këtë lëndë nuk është vërtetuar një lidhje e tillë.

5.2.6. Ri-shqyrtimi i një ankese

Në lëndën nr. 2011-28, *Y kundër EULEX-it*, ankuesi ka kërkuar nga Paneli që ta rishqyrtoj vendimin e tij të papranueshmërinë të datës 15 nëntor 2012 në pajtim me Rregullën 42 të Rregullores së punës së Panelit, duke argumentuar se Paneli në vendimin e tij nuk kishte marrë në konsideratë dëshmi të dokumentuara të caktuara.

Paneli ka pranuar kërkesën, mirëpo e ka vërtetuar vendimin e tij fillestar. Është konsideruar se procedura e ri-shqyrtimit e parashikuar në rregullën 42 kishte për qëllim të ofrojë një mekanizëm procedural përmes së cilit parashtruesi i ankesës mund të kërkojë rishqyrtimin e një vendimi të papranueshmërinë, aty ku një fakt i ri që ai nuk ka mundur ta dijë në kohën e ankesës fillestare do të kishte pasur ndikim vendimtar në konstatimet e Panelit.

Në atë rast, ankuesi nuk kishte arritur të tregojnë për ndonjë fakt të ri që lidhej me zbatimin e rregullës 42 dhe nuk kishte mundur të vërtetojë se si dokumentet e reja do të kishin ndikim vendimtar në gjetjet e bëra nga Paneli në vendimin e tij të papranueshmërisë.

5.2.7. Neni 3 i KEDNJ

Disa raste kanë të bëjnë me ankesat sipas nenit 3 të KEDNJ, kryesisht në lidhje me keqtrajtimin e pretenduar në burg (*Krasniqi kundër EULEX-it*, 2013-02 dhe *Susaj kundër EULEX-it*, 2013-16). Të gjitha këto ankesa janë gjetur të papranueshme. Paneli ka përsëritur jurisprudencën e GJEDNJ-së se keqtrajtimi duhet të mbërrijë një nivel minimal të ashpërsisë në qoftë se duhet të hynë në kuadër të nenit 3. Është gjetur se në asnjë rast pranë Panelit, ankuesit nuk kishin dhënë ndonjë hollësi që do lejonte që të konkludonin se trajtimi i tyre përbënte torturë, trajtim çnjerëzor apo poshtërues brenda kuptimit të nenit 3 të KEDNJ ose brenda kuptimit të nenit 1 të Konventës kundër Torturës, ose neni 165 të Kodit të Përkohshëm Penal të Kosovës (KPPK).

Në lëndën nr. 2012-08, *Halili kundër EULEX-it*, Paneli ka shqyrtuar detyrimin procedural të EULEX-it për të hetuar shkeljet e pohuara të nenit 3 të Konventës dhe ka vënë në dukje se kjo mund të ngritët në rrethana të caktuara. Konkretisht, neni 3.3 i Ligjit nr. 03/L-053 për kompetencat, përzgjedhjen e

lëndëve dhe caktimin e lëndëve të gjyqtarëve dhe prokurorëve të EULEX-it në Kosovë (Ligji mbi Kompetencat) numëron veprat penale që nxisin kompetencat e prokurorëve të EULEX-it. Sipas nenit 12 të Ligjit mbi Kompetencat, prokurorët e EULEX-it kanë autoritetin për të marrë përsipër një hetim apo ndjekjen e ndonjë vepre tjetër penale në rast se prokurorët e Kosovës nuk ishin të gatshëm ose ishin të paaftë për të kryer detyrat e tyre dhe kjo mosgatishmëri apo paaftësi mund të rrezikojë hetimin e duhur ose ndjekjen penale të asaj çështjeje. Megjithatë, Paneli ka vënë në dukje se në mënyrë që të nxitet një mundësi e tillë, rasti do të duhej t'i referohet së pari një prokurori publik vendor. Në qoftë se më pas prokurori vendor nuk do të ishte i gatshëm ose do të ishte i paaftë për t'u marrë me të, ankuesi mund të njoftojë kryeprokurorin e EULEX-it, i cili më pas do të vendos nëse do të caktojë rastin tek një tjetër prokuror publik i Kosovës ose tek një prokuror i EULEX-it. Pasi nuk ishte kështu, Paneli ka konstatuar se ankesa ka dalë jashtë kufijve të mandatit ekzekutiv të EULEX-it në Kosovë dhe rrjedhimisht jashtë juridiksionit të vet.

6. Aktivitetet e Panelit

6.1. Fushata publike informuese 2013

Dokumenti i Konceptit të Llogaridhënies i datës 29 tetor 2009 deklaroi, ndër të tjera në paragrafin E, se "... EULEX-i në Kosovë do të sigurojë shpërndarje të duhur të informacionit publik rreth Panelit dhe punës së tij ...".

Komandanti i Operacioneve Civile ka deklaruar në paragrafin 3 të Udhëzimit të tij të datës 13 nëntor 2009 në lidhje me Panelin se "Udhërrëfyesi" për Planifikim Civil dhe Mundësi Operacionale duhet të përfshijnë, ndër të tjera "përgatitjen e një fushate gjithëpërfshirëse të marrëdhënies me publikun".

Prandaj, Paneli siç përshkruhet më herët në këtë raport ka qenë i angazhuar në kryerjen e një fushate të gjerë në terren për të informuar popullatën rreth Panelit që nga qershori i vitit 2010. Fushata ka qenë mjaft efektive në ngritjen e informimit rreth Panelit, veçanërisht në zonat urbane ku EULEX-i ka një paraqitje më të madhe.

Megjithatë, siç theksohet në raportet e mëparshme vjetore, pavarësisht prej përpjekjeve të mëdha të Panelit, vazhdon të jetë një mungesë e theksuar e ndërgjegjësimit dhe njohurive rreth Panelit, mandatit dhe punës së tij në popullatë në disa zona urbane dhe në shumë zona rurale. Për këtë arsye është ndjerë se transmetimi i një reklame në TV dhe radio në vitin 2014 në masë të madhe do t'i ndihmonte Panelit të arrijë tek popullata në zonat urbane dhe rurale, në veçanti në rajonet e largëta të Kosovës.

Paneli dhe Sekretariati kanë vazhduar me kryerjen e fushatës informuese në terren gjatë vitit 2013. Synimi kryesor i kësaj fushate ka qenë në gjyqësorin e Kosovës, OJQ-të, përfaqësuesit e shoqërisë civile, si dhe në kisha dhe organe të tjera fetare. Paneli gjithashtu është angazhuar në intervista në media, ndërsa Sekretariati ka marrë pjesë në konferenca, seminare dhe debate të ndryshme lidhur me të drejtat e njeriut. Sekretariati dhe Paneli kanë shtuar aktivitetet e tyre të fushatës informuese në veri të Mitrovicës pasi gjendja e sigurisë ka lejuar një gjë të tillë.

Sekretariati gjithashtu ka zhvilluar një vizitë gjatë fushatës për informim publik në Serbi, ku ka mbajtur një seminar për projektin "Përkrahje e mëtutjeshme për zbatimin e Strategjive për personat e zhvendosur brenda vendit, refugjatë dhe të kthyer - Ndihmë Juridike", financuar nga Delegacioni i Bashkimit Evropian në Serbi. Më pas Paneli dhe Sekretariati janë takuar me personelin e Projektit në dy raste të tjera për t'i njoftuar ata rreth aktiviteteve të veta dhe për të ofruar një prezantim rreth nenin 6 të KEDNJ.

Formati i takimeve gjatë fushatës informuese ka përfshirë një prezantim të shkurtër rreth mandatit, procedurave, funksioneve dhe operacioneve të Panelit, si dhe një informatë e shkurtër rreth ligjit në fuqi sipas të cilit funksion Paneli. Ka pasur edhe mundësi për pyetje dhe përgjigje si dhe diskutim dhe debat atëherë kur ka qenë e përshtatshme. Janë shpërndarë po ashtu edhe materiale informuese të Panelit si fletëpalosje dhe postera në gjuhën angleze, shqipe dhe serbe.

Në vitin 2013, Paneli ka vazhduar me takimet e veta të kohëpaskohshme me shefin e Misionit, zëvendës shefin e Misionit dhe zyrtarë të tjerë të lartë të EULEX-it. Me ftesë të znj. Jaroslava Novotna, zëvendës shefe, prokurore e Divizionit Ekzekutiv dhe kryeprokurore e EULEX-it, Paneli ka bërë një prezantim mbi mandatin, operacionet dhe procedurat e veta për prokurorët ndërkombëtarë dhe zyrtarët ligjor të EULEX-it, duke elaboruar rreth jurisprudencës së Panelit, me theks të veçantë rreth ankesave të parashtruara pranë Panelit lidhur me vendimet dhe veprimet e prokurorëve të EULEX-it.

Ka pasur një përparim të mirëpritur gjatë përgatitjes së fushatës së Panelit për TV dhe radio. Një spot i shkurtër televiziv ku shpjegohet roli i Panelit dhe ku ofrohet informacion mbi procedurën për ankesë është filmuar dhe redaktuar nga zyra për shtyp dhe informim publik e EULEX-it.

6.2. Trajnimi hyrës për personelin e EULEX-it

Sekretariati ka marrë pjesë në programin e trajnimit hyrës të EULEX-it për pjesëtarët e ardhshëm të personelit të EULEX-it. Formatu përbëhet prej një prezantimi që bëhet nga Paneli me një kohë të caktuar për pyetje dhe përgjigje. Ky është një forum shumë i dobishëm për të informuar personelin e ardhshme rreth mandatit të Panelit dhe për të rritur paraqitjen e Panelit tek personeli i EULEX-it në zonën e misionit.

Kjo është konsideruar të jetë veçanërisht e rëndësishme për shkak se kjo i ofron Panelit një mundësi që të informojë personelin e EULEX-it në Divizionin Ekzekutiv rreth implikimeve në llogaridhënie sa i përket shkeljeve të të drejtave të njeriut gjatë ushtrimit të funksioneve të tyre ekzekutive. Paneli e konsideron këtë të jetë një mundësi e rëndësishme për të siguruar që i gjithë personeli që vjen për herë të parë të jenë të vetëdijshëm për obligimin e tyre për të përmbushur standardet përkatëse të të drejtave të njeriut në kryerjen e funksionit të tyre.

6.3. Faqja e internetit

Sekretariati është përgjegjës për rregullimin dhe mirëmbajtjen e faqes së internetit të Panelit: www.hrrp.eu. Kjo faqe përmban informata të dobishme rreth mandatit, funksioneve, veprimtarive dhe punës së Panelit, si dhe komunikatave për shtyp, statusin e tanishëm të lëndëve në pritje dhe lëndëve të përfunduara, përfshirë këtu të gjitha vendimet e marra nga Paneli.

Aty gjithashtu ka informata rreth ligjit në fuqi lidhur me të drejtat e njeriut, si dhe rreth formularëve dhe udhëzimeve për paraqitjen e ankesave në gjuhën angleze, shqipe dhe serbe. Lëndët e Panelit janë të organizuara në mënyrë që palët e interesuara mund të kenë qasje të lehtë dhe po ashtu aty mund të kërkohet lehtë. Sekretariati vazhdimisht përpiqet për të zhvilluar dhe për të përmirësuar faqen e internetit edhe më tej. Në 2013 Paneli ka shtuar [tabelën e jurisprudencës së Panelit](#). Kjo tabelë mundëson që jurisprudenca e Panelit gjithnjë e në rritje të kërkohet përmes subjektit të lëndës (edhe rreth pranueshmërisë dhe përmbajtjes) dhe është krijuar për të siguruar qasje të gatshme në jurisprudencën e Panelit.

7. Çështjet operative/administrative/të personelit

7.1. Papranueshmëria e ankesave

Si në vitin paraprak, Paneli ka konstatuar se një përqindje e lartë e ankesave janë shpallur të papranueshme. Këto ankesa *ndër të tjera* përmbajnë mangësitë e shënuara në vijim: ankesat kanë qenë haptas të pabazuara në kuptimin se ato nuk kanë parashtruar dëshmi *prima facie* rreth shkeljeve të të drejtave të njeriut; ato kanë dalë jashtë mandatit ekzekutiv të EULEX-it dhe për pasojë kanë qenë jashtë juridiksionit të Panelit; ankesat janë paraqitur pas skadimit të afatit kohor të përcaktuar në Rregulloren e Punës të Panelit (shih Rregullën 25 paragrafin 3) ose nuk ishin në përputhur *ratione temporis* me Rregulloren e Punës, pasi ato kanë përmendur ngjarjet që kishin ndodhur para themelimit të Panelit.

Mund të vihet re se ankuesit shumë rrallë përfaqësohen nga avokatë dhe duket se ankuesit shpeshherë e cilësojnë Panelin si organ ku drejtohen atëherë kur të gjitha mjete e tjera ligjore të jenë shterur. Gjithashtu mund të jetë që ankuesit kanë shfryer zhgënjimin e tyre nganjëherë sa i përket ritmin tejet të ngadalshëm të procedurave gjyqësore në gjykatat e Kosovës.

Gjatë fushatës informuese në vitin 2014, Paneli do të kërkoj t'ju qaset këtyre çështjeve dhe mangësive me një theks të veçantë në ofrimin e informatave lidhur me kriteret për pranueshmërinë e ankesave.

7.2. Buxheti

Paneli nuk ka ndonjë buxhet të dedikuar për vete dhe kështu sa i përket kësaj është plotësisht i varur prej sistemit buxhetor të EULEX-it. Kjo mënyrë nuk ka penguar në mënyrë të shprehur në punën e Panelit në baza ditore gjatë periudhës raportuese. Megjithatë, më shumë liri veprimi në buxhet, për shembull do t'i mundësojë Panelit të marrë vendime të veta thjesht lidhur me çështjet administrative, si p.sh. zgjerimin e fushatës informuese, në veçanti fillimin e transmetimit në TV/radio, pa ju drejtuar EULEX-it në Kosovë.

Përndryshe, Paneli është shumë i kënaqur me mbështetjen që ofrohet nga EULEX-i. Duhet të ritheksohet se qasja në burimet e veta buxhetore do ta ndihmonte Panelin në punë shumë. Kjo po ashtu do të rriste edhe më tej pavarësinë e tanishme dhe atë të perceptuar të Panelit dhe në këtë mënyrë do t'ia rriste vlerën misionit të EULEX-it në Kosovë dhe do ta rriste edhe më tej besueshmërinë e EULEX-it si mision i Sigurimit të Përbashkët dhe Politikës së Mbrojtjes në kontekstin e të drejtave të njeriut.

Paneli dëshiron të shfrytëzoj këtë mundësi të falënderohet sa i përket bashkëpunimit të shkëlqyeshëm, mbështetjes dhe ndihmës administrative që ka pranuar nga EULEX-i në Kosovë dhe në veçanti për shërbimin kompetent nga Zyra për çështje Gjinore dhe të Drejta të Njeriut, përmes së cilës Paneli komunikon dhe bashkëvepron në mënyrë efektive me EULEX-in në Kosovë lidhur me shqyrtimin e lëndëve.

8. Komentim ndërkombëtar sa i përket llogaridhënies së të drejtave të njeriut për misionet ndërkombëtare në Kosovë

8.1. “Veçantia evropiane?”

George Nolte dhe Helmut Philip Aust, Universiteti i Humbolt-it, Berlin, Gjermani [*Global Constitutionalism* (2013), 2:3, 407 – 436,] Cambridge University Press, 2013.

1. Autorët në dokumentin e tyre kanë elaboruar lidhur me praninë e misionit të EULEX-it në Kosovë, i cili ka hyrë pas shpalljes së njëanshme të pavarësisë në vitin 2008. Përderisa EULEX-i ka më pak kompetenca të rëndësishme ekzekutive se sa misioni i mëparshëm i UNMIK-ut, ai ruan disa kompetenca ekzekutive. Këto kompetenca janë kryesisht korrigjuese, mirëpo ato gjithashtu përfshijnë hetimin dhe ndjekjen penale të krimeve të rënda dhe krimeve të ndjeshme.
2. Për shqyrtimin e përputhshmërisë së ushtrimit të këtyre kompetencave me të drejtat e njeriut, BE-ja ka krijuar Panelin për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut (PSHDNj). Megjithatë “koncepti i llogaridhënies” i PSHDNj-së është një dokument i kufizuar, i cili ngre pyetje në lidhje me transparencën dhe sigurinë juridike. PSHDNj-ja nuk mund të marrë vendime detyruese kundër veprimeve të EULEX-it, mirëpo thjesht “paraqet konkluzionet e veta tek shefi i Misionit dhe kur është e nevojshme bën rekomandime jo detyruese për veprime korrigjuese”. Po ashtu është shënuar se rekomandimet e Panelit nuk mund të rezultojë në kompensim monetar.
3. Edhe pse kompetencat ekzekutive të EULEX-it janë mjaft të kufizuara, dimensionimi simbolik i këtij aranzhimi duket të jetë se BE-ja nuk është e përgatitur që t’i nënshtrohet të njëjtave standarde të shqyrtimit gjyqësor të detyrueshëm, të cilat për shembull i kërkon nga vendet kandidatë si kusht për anëtarësim në Bashkimin Evropian.
4. Iu është referuar pikës që Komisioni i Venecias i Këshillit të Evropës me kujdes ka këmbëngulur në opinionin e vet të vitit 2010 në lidhje me këtë aranzhim:

“Paneli për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut i BE-së duket se në përgjithësi është në përputhje me rekomandimet të cilat Komisioni i Venecias kishte formuluar në vitin 2004 në lidhje me një mekanizëm këshillues për shqyrtimin e të drejtave të njeriut për Kosovën. Megjithatë, Komisioni i Venecias dëshiron të theksojë se këto rekomandime ishin bërë në kontekst të një situatë emergjente pas luftës vetëm lidhur me institucionet që veprojnë pjesërisht. Në Kosovë sot mbizotëron një situatë ndryshe dhe në këtë aspekt Komisioni i Venecias është i mendimit se për aq kohë sa veprimet e EULEX-it janë mbështetëse apo korrigjuese brenda një situatë përgjithësisht të qetë, EULEX-i duhet të vihet nën një shqyrtim² më të rreptë”.

8.2. “Krijimi i llogaridhënies për organizatat ndër-qeveritare dhe shtete”

² Shih Komisionin Evropian Demokraci nëpërmjet Ligjit (Komisioni i Venecias), Opinioni mbi mekanizmat ekzistues në rishikimin e përputhshmërisë së standardeve të të drejtave të njeriut të Akteve nga UNMIK-u dhe EULEX-it në Kosovë të miratuar më 17-18 dhjetor 2010, CDL-AD) (2010) 051 Par 58.

Hyrje

1. Regjimi bashkëkohor ndërkombëtar i të drejtave të njeriut ka evoluar ngadalë, por në mënyrë progresive që nga fillimi i shekullit të 20-të. Një nga arsyet për këtë ecje të ngadalshme ka qenë shkaku i konfliktit të pandarë midis të drejtave ndërkombëtare të njeriut dhe sovranitetit të shtetit tradicional. Gjithnjë e më shtetet vazhdojnë të pranojnë nevojën për një sistem të përbashkët të drejtave të njeriut duke iu nënshtruar standardeve ndërkombëtare.
2. Megjithatë, që nga themelimi i Deklaratës Universale për të Drejtat e Njeriut (DUDNj) deri në sistemin e mëvonshëm të Organit të Traktatit të KB-së, shtetet kanë qenë përqendrimi kryesor i regjimit ndërkombëtar të të drejtave të njeriut. Për shkak të natyrës shtetërore centrike të OKB-së, vetëm shtetet mund të ratifikojnë traktatet e të drejtave të njeriut. Vetëm shtetet e tash së fundi edhe individë mund të gjykohen për shkelje të rënda të të drejtave të njeriut në Gjykatën Ndërkombëtare të Drejtësisë dhe Gjykatën Penale Ndërkombëtare. Së fundi, janë shtetet ato që kanë fuqinë për të kontribuar në vendimmarrje ndërkombëtare në çështjet globale.

Qëllimi i esesë

3. Sot 90 për qind e konflikteve në botë janë të brendshme brenda një shteti të njohur e jo konflikte midis shteteve. Natyra e këtij lloji të konfliktit ka bërë që shumë individë tashmë jenë nën kontrollin efektiv të akterëve jo-shtetërorë, duke përfshirë organizatat ndërkombëtare dhe shtetet që nuk janë të njohura. Një nga shembujt më të dalluara është ajo e Kosovës.
4. Qëllimi i kësaj eseje është për të diskutuar se si këto zhvillime kanë dalë kundër sistemit bashkëkohor ndërkombëtar dhe se çfarë efekti mund të kenë ato mbi situatën e shteteve jo të njohura dhe organizatave ndërkombëtare. Situata në Kosovë dhe roli i Panelit për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut të BE-së janë diskutuar si një shembull se si regjimi i tanishëm i të drejtave të njeriut mund të bëhet i pasuksesshëm nga sistemi që është dizajnuar për ta mbrojtur atë. Shkrimtari vlerëson efektet e tij në Kosovë duke përdorur një analizë ligjore dhe politike të situatës që mbizotëron në Kosovë.

Paneli për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut

5. Situata në Kosovë paraqet një pamje të rëndësishme në pasojat e përjashtimit të akterëve jo shtetëror prej regjimit të shtetit centrik ndërkombëtar të të drejtave të njeriut. Gjatë gjithë konfliktit në Kosovë dhe periudhës së pas konfliktit nga viti 1999 deri në kohën e tanishme, subjekte të ndryshme duke përfshirë organizata ndërkombëtare, kompani private, akterë të armatosura dhe tani shteti i vetëshpallur i Kosovës kanë qenë aktiv brenda territorit pa dhënë llogaridhënie. Në këtë pjesë, autori përqendrohet në efektet që mungesa e llogaridhënies dhe njohjes nga komuniteti ndërkombëtar mund të ketë në periudhën e pas konfliktit.
6. Misioni i UNMIK-ut i ka ndalur operacionet e veta në Kosovë në dhjetor të vitit 2008, e cila hapi rrugën për Misionin për Sundimin e Ligjit të Bashkimit Evropian në Kosovë (EULEX-i) për

³ <http://www.e-ir.info/2013/09/21/establishing-accountability-for-igos-and-states>.

të marrë gjithnjë e më shumë përgjegjësi, duke filluar me sektorin për sundimin e ligjit. Gjyqtarët në sistemin gjyqësor të EULEX-it kanë marrë reagime pozitive në raportet e Avokatit të Popullit për shkak të bashkëpunimit të tyre me Institucionin, ndërsa Paneli për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut i BE-së është themeluar në vitin 2009 për të shqyrtuar ankesat e shkeljeve të të drejtave të njeriut nga EULEX-i.

7. Megjithatë, autori vë në dukje se Paneli ka vetëm kompetenca për t'i dhënë rekomandime shefit të Misionit dhe një raport i pavarur i auditimit të lëshuar vitin e kaluar ka treguar se Misioni ka treguar pak rezultate për shkak të mungesës së bashkërendimit, kualifikimit të pamjaftueshëm të personelit dhe korrupsionit të përhapur në Kosovë⁴. Kjo u vu re në esenë se EULEX-i ka shkelur të drejtat e një grupi të dëshmitarëve, emrat dhe dëshmitë e të cilëve iu ishin dhënë autoriteteve shtetërore të Serbisë në një lëndë të vitit 2013, e cila është shqyrtuar nga Paneli për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut.
8. Është përgjegjësi e EULEX-it në Kosovë për të mbrojtur identitetin e dëshmitarëve, veçanërisht ata që kanë qenë dëshmitarë të krimeve të dhunshme dhe të cilët do të mund të jenë cak për shkak se japin publikisht mendimet të tyre. Sipas raportit, EULEX-i ka vendosur të mos zbatoj masat e përkohshme që ishin sugjeruar për të mbrojtur dëshmitarët, duke deklaruar se informacioni ishte bërë publik dhe se masat e mbrojtjes për këtë arsye nuk do të kenë efekt.
9. Duke vendosur që misionet e UNMIK-ut, EULEX-it dhe KFOR-it në Kosovë të ushtrojnë kontroll efektiv, autori mendon se pse ata nuk japin llogari për shkeljet e të drejtave të njeriut, apo një minimum përgjegjësie për detyrimet e shteteve ndaj individëve që janë nën qeverisjen e tyre në përputhje me të drejtën humanitare. Autori shton se është ironike që misioni i krijuar për të vendosur stabilitet, sundim të ligjit dhe vetëqeverisje demokratike në rajon në thelb ka natyrë autokratike. Ndërsa disa mund të argumentojnë se do të ishte tepër e komplikuar për ta mbajtur përgjegjëse një organizatë ndër-qeveritare sipas të drejtës ndërkombëtare, në një shënim pozitiv ai thotë se dikush mund t'iu drejtohet vendimit progresiv të BE-së për t'u pranuar në Gjykatën Evropiane të të Drejtave të Njeriut (GjEDNJ):

“Prandaj, hyrja në BE do të forcojë mbrojtjen e të drejtave të njeriut në Evropë, duke nënshtruar sistemin ligjor të BE-së ndaj kontrollit të jashtëm të pavarur. Gjithashtu ajo do t'i mbyll zbrazëtirat në mbrojtjen ligjore, duke i dhënë qytetarëve evropianë të njëjtën mbrojtje përballë veprimeve të BE-së ashtu siç tani ata i gëzojnë ato nga shtetet anëtare⁵”.

10. Në kohën kur Bashkimi Evropian, një organ ndër-qeveritar me më pak fuqi sesa UNMIK-ut apo KFOR-it mbi qytetarët e saj, së shpejti do të nënshtrohet nën juridiksionin e KEDNJ-së, autori argumenton se nuk ka arsye që organizatat ndërkombëtare të shfrytëzojnë imunitetin diplomatik si një mburojë, sidomos kur kompetencat e ofruara atyre janë absolute, dhe mjedisi në të cilin ata operojnë është i paqëndrueshëm dhe i ndjeshme për shkak të mungesës së mbrojtjes ligjore dhe politike. Përderisa mandati i misionit mund të jetë krijuar prej vullnetit të mirë, centralizimi i kontrollit absolut në një entitet është i rrezikshëm dhe mund të ketë një efekt të kundërt në ata për të cilët ishte krijuar fillimisht për t'i mbrojtur.

⁴ Nielsen, 'Korrupsioni mbizotëron në Kosovë përkundër miliona eurove', 2012, [HTTP://www.euobserver.com](http://www.euobserver.com)

⁵ Këshilli i Evropës, "Organizatat ndërkombëtare duhet të jetë i përgjegjshëm kur veprojnë si kuazi qeveri" Komisioneri për të Drejtat e Njeriut, Thomas Hammarberg.' Drejtoria e Komunikimit: Thomas Hammarberg: Komunikatë për shtyp 450, 8 qershor 2009.

Rekomandimet

11. Autori thekson se për aq kohë sa Kosova nuk ka status zyrtar dhe për këtë arsye nuk ka kompetencë juridike për të vepruar në emër të vet brenda komunitetit ndërkombëtar, një mision i OKB-së apo BE-së do të duhet të vazhdojë për të administruar territorin. Prandaj, është koha që komuniteti ndërkombëtar t'i lëshoj konceptet e veta të vjetruara të sovranitetit dhe të shtetësisë dhe të eksplorojnë zgjidhje të reja nëse dikush është për të parë zbatimin efektiv të të drejtave të njeriut në shtetet jo të njohura, siç është Kosova. Për të adresuar çështjet e veçanta të diskutuara në këtë ese, autori arrin në përfundim se ka dy sfida që duhet të trajtohen, ato të organizatave ndërkombëtare që veprojnë në situatat pas konflikteve dhe llogaridhënia për shtetet jo të njohura.
12. Një veprim i nevojshëm për misionet që janë të mandatuara në mënyrë efektive për të vepruar si "shtete surrogate" nga OKB-ja apo ndonjë organizatë tjetër rajonale ose ndërkombëtare është që të bëhen palë në DUDNJ dhe Traktate të tjera përkatëse të OKB-së. Pasi "Përgjegjësia për të mbrojtur" i ka dhënë tashmë OKB-së përgjegjësinë për të mbrojtur civilë nga shteti, atëherë kur vepron në cilësinë e një shteti, misionet e OKB-së duhet të kenë gjithashtu një përgjegjësi ndaj individëve nën administrimin e tyre. Misioneve që veprojnë në situata të konfliktit dhe pas konfliktit, ku sundimi i ligjit dhe strukturat qeverisëse janë të dobët nuk duhet t'iu jepet imunitet i pakufizuar, por duhet të pranojnë juridiksionin e një gjykate ndërkombëtare apo rajonale për operacionet e tyre ekstraterritoriale.
13. Qëllimi i imunitetit që iu është dhënë misioneve të OKB-së është për t'iu lejuar atyre që të veprojnë pa ndërhyrje nga shteti ku veprojnë. Siç është theksuar në raportin e parë të Avokatit të Popullit të Kosovës në një referencë për UNMIK-un "*kur një mision është duke vepruar si 'shtet surrogat' ai ka kontroll efektiv në të gjitha aspektet administrative dhe për këtë arsye nuk ka nevojë për imunitet nga vetja*⁶".

Imuniteti për autoritetet publike thjesht mban një territor në një gjendje të përhershme emergjente, aty ku të drejtat e njeriut janë pezull dhe ku ka mosndëshkim. Ashtu siç ka deklaruar Komisioneri për të Drejtat e Njeriut i Këshillit të Evropës në vitin 2009:

"Kur organizatat ndërkombëtare ushtrojnë kontroll ekzekutiv dhe legjislativ si një shtet surrogat, ato duhet të detyrohen nga të njëjtat kontrolle dhe ekuilibra ashtu siç kërkohet nga një qeveri demokratike. Mungesa e llogaridhënies mund të minojë besimin e publikut në organizata ndërkombëtare dhe në këtë mënyrë moralin e tyre për të qeverisur. Ajo gjithashtu nxit klimën e mosndëshkimit dhe vendos një model negativ për qeveritë vendore⁷".

14. Dhënia e statusit të shtetit vëzhgues jo anëtar shteteve jo të njohura siç është Kosova do t'i lejonte atyre jo vetëm për të aderuar në traktatat e të drejtave të njeriut, por edhe për t'u dhënë atyre mundësinë për të hyrë në marrëveshje të tjera ndërkombëtare dhe në organizata. Duke pasur aftësinë për të hyrë në mënyrë të pavarur në marrëveshje ndërkombëtare, jo vetëm që mund të sjellë stabilitet ekonomik, por gjithashtu mund t'i detyrojë ata që të përmirësojnë strukturat e sundimit të ligjit për t'i përmbushur kriteret e pranimit.

⁶ Institucioni i Avokatit të Popullit në Kosovë, 'Raport Special Nr. 1 Faqe 8, 26 prill 2001.

⁷ Këshilli i Evropës, "Organizatave ndërkombëtare duhet të jetë i përgjegjshëm kur veprojnë si kuazi qeveri" Komisioneri për të Drejtat e Njeriut, Thomas Hammarberg.' Drejtoria e Komunikimit: Thomas Hammarberg: Komunikatë për shtyp 450, 8 qershor 2009.

Përveç kësaj, studimet e shumta empirike kanë treguar se ratifikimi i traktateve të OKB-së në shtetet e sapo formuara demokratike me nivele të larta të shkeljeve të të drejtave të njeriut mund të ketë ndikim më të madh, sidomos në ato shtete me një shoqëri civile të fortë. Kjo do të thotë se aderimi, së bashku me mbështetjen e vazhdueshme të bashkësisë ndërkombëtare për shoqërinë civile, mund të ketë një ndikim të madh. Së fundi, aftësia për të aderuar në gjykatat ndërkombëtare mund t'i sigurojë Kosovës një mjet për mbrojtje nga shtetet e tjera, ndërkohë që pranimi në Kodin Penal Ndërkombëtar mund të jetë një mjet i vlefshëm që shfrytëzohet për të luftuar korrupsionin.

Përfundime

15. Autori thekson se sfida komplekse dhe shumë dimensionale e vendosjes së përgjegjësisë për organizatat ndërkombëtare dhe shtetet jo të njohura mund të trajtohet duke adresuar nevojën për përfshirjen e akterët jo shtetëror në nivelin ndërkombëtar qoftë si bartës të të drejtave dhe bartës të obligimeve, veçanërisht në situatat pas konfliktit d.m.th. në një komunitet global në të cilin të gjithë të interesuarit janë të mbrojtur nga dhe të përgjegjshëm për zbatimin e standardeve globale të të drejtave të njeriut. Megjithatë, kjo mund të realizohet vetëm atëherë kur bashkësia ndërkombëtare tejkalon konceptet tradicionale të shtetësisë dhe sovranitetit.
16. Autori përfundon duke thënë se është arritur përparimi rreth llogaridhënies lidhur me të drejtat e njeriut përmes evolucionit të konceptit “Përgjegjësia për të mbrojtur” dhe statusi i ri i Palestinës duhet të shërbejë për të nxjerrë në pah përparimin që mund të arrihet në zbatimin universal të të drejtave të njeriut atëherë kur këto koncepte nuk janë përdorur si pengesa. Në një epokë të globalizimit, akterët jo shtetëror janë duke u bërë gjithnjë e më të rëndësishëm në skenën ndërkombëtare dhe si të tillë duhet të përfshihen në evoluimin e regjimit të të drejtave të njeriut.

8.3. “Përgjegjësia e organizatave ndërkombëtare për shkeljet e të drejtave të njeriut”

Raporti i Komisionit për Çështje Ligjore dhe të Drejtat e Njeriut të Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Evropës (APKE), 17 dhjetor 2013, Doc. 13370⁸

Hyrje

1. Byroja e Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Evropës (APKE) ka vendosur për t'ia referuar Komisionit për Çështje Ligjore dhe të Drejta të Njeriut për raportin, mocionin për një rekomandim rreth “Llogaridhënies së institucioneve ndërkombëtare për shkeljen e të drejtave të njeriut” më 9 mars 2012. Komiteti ka mbajtur një seancë lidhur me këtë çështje me ekspertë për të drejtat e njeriut në bazë të një *memorandum hyrëse* në Izmir, Turqi më 27 maj 2013. Komiteti ka miratuar më pas njëzëri projekt-rezolutën dhe projekt-rekomandimin në Paris më 6 nëntor 2013. Tekstet do të debatohen në seancën e ardhshme të APKE-së që mbahet në Strasburg më 31 janar 2014.

⁸ <http://assembly.coe.int/nw/xml/XRef/Xref-XML2HTML-en.asp?fileid=20310&lang=en>

2. Memorandumi hyrës gjerësisht merret me konceptin e llogaridhënies për shkeljen e të drejtave të njeriut gjatë ushtrimit të mandatit ekzekutiv, pengesat në zbatimin e llogaridhënies, imuniteti para gjykatave shtetërore/gjykatave vendore, si dhe heqjen e së njëjtës nga organizatat ndërkombëtare në operacionet paqeruajtëse. Dokumenti gjithashtu merret me mekanizmat llogaridhënës ndërkombëtare të jashtëm lidhur me të drejtat e njeriut, mekanizmat e brendshëm llogaridhënës dhe llogaridhënia e shteteve anëtare.

Koncepti llogaridhënës

3. Ky raport thekson se baza thelbësore e llogaridhënies së të drejtave të njeriut është shqyrtimi i punës së zotëruesve të pushtetit duke kërkuar informacion, sqarim dhe arsyetim. Llogaridhënia e organizatave ndërkombëtare për të drejtat e njeriut është trajtuar tradicionalisht si një çështje e llogaridhënies ndaj vendeve anëtare të organizatës ndërkombëtare.
4. Në të kundërtën, ky memorandum hyrës i kushton vëmendje të veçantë mundësisë që aplikanti të kërkojë llogaridhënie për të drejtat e njeriut nga organizatat ndërkombëtare. Duke pasur parasysh natyrën ligjore të pikës së referimit në këtë memorandum, kryesisht përqendrimi është në mjetet vendimmarrëse të zbatimit të llogaridhënies.

Paneli Këshillëdhënës për të Drejtat e Njeriut dhe Paneli për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut

5. Memorandumi shpjegues i referohet edhe Panelit Këshillëdhënës për të Drejtat e Njeriut të UNMIK-ut (PKDNj), i themeluar nga OKB-ja dhe Panelit për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut të BE-së (PSHDNj), i cili është themeluar me detyra të ngjashme në lidhje me EULEX-in⁹. Memorandumi thekson se të dy këto panele kanë qenë të gatshëm për të adresuar shkeljet e rënda dhe të diskutueshme të të drejtave të njeriut. Raporti gjithashtu përmend mungesën e njohjes së mandateve dhe funksioneve të paneleve brenda shoqërisë kosovare.
6. Memorandumi ka vënë re se panelet deri tani kanë nxjerrë një numër të vendimeve, përgjithësisht duke u mbështetur në Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe kanë vënë re se organizatat përkatëse kanë shkelur të drejtat e Konventës në një numër rastesh. Panelet gjithashtu kanë qenë të gatshëm për të adresuar shkeljet e rënda dhe të diskutueshme të drejtave të njeriut dhe ka vënë re se PKDNj-ja e UNMIK-ut së voni ka gjetur në *Jočić* se UNMIK-u ka shkelur nenet 2 dhe 3 të KEDNj-së duke mos hetuar në mënyrë të duhur zhdukjen dhe vdekjen e një civili serb kosovar¹⁰.
7. Edhe pse krijimi i këtyre dy paneleve përbën një përmirësim të konsiderueshëm në drejtim të mbrojtjes së të drejtave të njeriut nga ana e organizatave ndërkombëtare në rolin ekzekutiv, panelet iu kanë nënshtruar disa kritikave, ndër të tjera se rekomandimet e tyre nuk janë ligjërisht të detyrueshme dhe se UNMIK-u dhe EULEX-i nuk janë të obliguar të veprojnë sipas tyre.
8. Është vënë në dukje se prej janarit 2012, UNMIK-u në Kosovë nuk kishte ofruar kompensim për shumë viktime të shkeljeve të të drejtave të njeriut, siç ishte rekomanduar nga Paneli.

⁹ Llogaridhënia e Organizatave ndërkombëtare për shkeljet e të drejtave të njeriut, faqe 15, par. 58, Asambleja Parlamentare, Këshilli i Evropës.

¹⁰ Paneli Këshillëdhënës për të Drejtat e Njeriut, 23 prill 2013, Svetlana Jočić kundër UNMIK-ut, lënda nr. 34/09. Gjithashtu në lidhje me këtë shih Kosovë: Trashëgimia e UNMIK-ut, Dështimi për të dhënë drejtësi dhe dëmshpëerblim për të afërmit e të rrëmbyerve, Amnesty International, 2013.

Në krahasim, PSHDNj-ja e BE-ja nuk është e autorizuar madje as edhe për të rekomanduar ndonjë pagesë kompensimi nga ana e EULEX-it¹¹.

9. Përveç kësaj, juridiksioni i PKDNj-së ishte i kufizuar në veprimet e UNMIK-ut pas themelimit të Panelit në vitin 2007, që është shoqëruar me periudhën më të shprehur të dhunës që ka ndodhur në rajon në vitin 1998/99. Ky fakt i vetëm thekson rëndësinë e krijimit të mekanizmave për shqyrtimin e të drejtave të njeriut në *fillim* të ndonjë ndërhyrje nga një organizatë ndërkombëtare e jo më vonë gjatë misionit kur organizata mund të ketë pranuar një numër të ankesave lidhur me shkeljet e të drejtave të njeriut.
10. Memorandumi ka vënë re se të dy Panelet ofrojnë një model prototip për përdorim të mundshëm nga Kombet e Bashkuara dhe Bashkimi Evropian në misione të ardhshme paqeruajtëse dhe misione për siguri evropiane dhe politika të mbrojtjes, ku secila prej këtyre dy organizatave mund të marrë ndonjë rol administrativ/ekzekutiv.
11. Memorandumi përfundon me vërejtjet se përdorimi i ardhshëm dhe shfrytëzimi i mekanizmave të tillë llogaridhënës i të drejtave të njeriut, si dhe nevoja për të ofruar organe me kompetenca për të monitoruar zbatimin e vendimeve të Paneleve meriton vëmendje të vazhdueshme.

8.4. Raporti i Amnesty International “Kosovë – Trashëgimia e UNMIK-ut”

“Dështimi për të ofruar drejtësi dhe dëmshpërblim për të afërmit e të rrëmbyerve”, gusht 2013¹²

Hyrje

1. Paneli Këshillëdhënës për të Drejtat e Njeriut i UNMIK-ut (PKDNj) dhe EULEX-i kanë komentuar raportin e mësipërm të Amnesty International, veçanërisht në lidhje me hapat që PKDNj-ja, EULEX-i në Kosovë dhe organet e tjera kompetente mund të marrin për të siguruar se hetimet penale në zhdukjen dhe vrasjen e anëtarëve të familjes së parashtruesve të ankesës në PKDNj-së pas konfliktit të vitit 1998/1999 të vazhdohet dhe se autorët e krimit të dalin përpara drejtësisë. Paneli i UNMIK-ut është themeluar nga Kombet e Bashkuara në vitin 2007 për të shqyrtuar ankesat nga aplikantët, drejtat e të cilëve pretendohet se janë shkelur nga UNMIK-u gjatë ushtrimit të mandatit të tij ekzekutiv.

Çështjet në fjalë

2. Raporti është bazuar në të gjeturat e PKDNj-së në zhdukjen në fjalë dhe vrasjet të cilat janë shqyrtuar në vitin 2012 dhe 2013. Aty thuhet se dështimi i UNMIK-ut për të hetuar rastet e personave të zhdukur është zbuluar në ankesat që ishin shqyrtuar nga PKDNj-ja deri më sot. PKDNj-ja ka pranuar rreth 250 ankesa lidhur me këto në vitin 2008/9 nga të afërmit e personave të humbur, kryesisht serbë të Kosovës, të cilët besohet se kanë qenë të rrëmbyer nga Ushtria Çlirimtare e Kosovës (UÇK). Edhe pse përqendrohet kryesisht në rrëmbimin e serbëve të Kosovës, kërkimi i vetë Amnesty International ka çuar në gjetje të ngjashme në lidhje me dështimin e UNMIK-ut për të hetuar zhdukjen e shqiptarëve të Kosovës nga forcat serbe.

¹¹ Paneli për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut i BE-së, Raporti vjetor 2012, faqe 39.

¹² <http://www.amnesty.org/en/library/info/EUR70/009/2013/en>.

3. Raporti vuri në dukje se opinionet fillestare të PKDNj-së më shumë se vërtetuan gjetjet e Amnesty International se raportet e tilla të personave të zhdukur nuk ishin hetuar menjëherë, në mënyrë të paanshme dhe me kujdes nga policia e UNMIK-ut dhe se të afërmit rrallëherë ishin njoftuar rreth ndonjë përparimi që ishte bërë në ato hetime. Në të vërtetë, në disa prej ankesave të shqyrtuara deri më tani, PKDNj-ja ka konstatuar se fare nuk janë zhvilluar hetime ose hetimet kanë përfunduar atëherë kur eshtrat e personave të zhdukur iu ishin kthyer familjeve të tyre.
4. Raporti gjithashtu ka vënë në dukje se UNMIK-u ka vazhduar të shkelë të drejtat e njeriut të pjesëtarëve të familjes së të zhdukurve duke dështuar të zbatoj rekomandimet e PKDNj-së sa i përket dëmshpërblimit.
5. Raporti gjithashtu ka deklaruar se: “Mungesa e dukshme e ndonjë reagimi të duhur nga policia e UNMIK-ut mund t’i ketë sugjeruar kryesve të veprave se autoritetet nuk ishin në gjendje apo ishin jo të gatshëm për të hetuar veprat e tilla kriminale. Një qëndrim i tillë nga ana e autoriteteve ndaj krimeve më të rënda në çdo shoqëri e sidomos në rrethanat e pas konfliktit, në mënyrë të pashmangshme krijon një kulturë të mosndëshkimit në mesin e kriminelëve dhe mund të çojë vetëm në një përkeqësim të situatës. Problemet të cilat UNMIK-u i kishte hasur në fillim të misionit të tij [...] nuk e arsyetojnë mosveprimin e tillë, qoftë në fillim ose më vonë¹³”.
6. Megjithatë raporti ka vënë në dukje po ashtu se përgjegjësitë e UNMIK-ut për polici dhe drejtësi kishin përfunduar kur Bashkimi Evropian për Sundim të Ligjit në Kosovë (EULEX-i) kishte marrë përsipër funksionet e policisë, prokurorisë dhe funksionet gjyqësore më 9 dhjetor 2008. Këto përgjegjësi përfshinin hetimin dhe ndjekjen penale të krimeve të rënda, si dhe krimet nën ligjin ndërkombëtar.
7. Në lidhje me EULEX-in, raporti ka vërejtur se: “Pak prej rasteve të përfshira në këtë raport janë hetuar deri më tani nga EULEX-i. Edhe pse policia dhe prokurorët e EULEX-it kanë bërë përparim në hetimin e rasteve të zhdukjes së shqiptarëve të Kosovës nga forcat serbe, është bërë pak përparim deri tani në hetimet dhe ndjekjet penale që kanë lidhje me rrëmbimet e serbëve dhe pakicave të tjera¹⁴”.
8. Në këtë kontekst, znj. Sian Jones nga Amnesty International ka përmbledhur situatën si në vijim: “Përderisa tani i takon EULEX-it për të hapur hetimet në rastet e rrëmbimeve dhe vrasjeve të pas luftës, UNMIK-u duhet të ofroj fonde të mjaftueshme për t’iu ofruar të të afërmit të personave të zhdukur kompensim të duhur dhe efektiv për dëmet morale dhe dhembjen dhe vuajtjen e tyre, në pajtim me ligjin dhe standardet ndërkombëtare¹⁵”.

Rekomandimet

¹³ Ky koment paraqitet në disa Opinione të PKDNj-së, shih për shembull lëndën 312/09, *Momcilo Milenkovic kundër UNMIK-ut*, Opinion, i miratuar më 6 qershor 2013, par. 87. Secili Opinion i PKDNj-së i cituar në këtë raport gjendet në <http://www.unmikonline.org/hrap/Alb/Pages/Rastet-sipas-Date%c3%abs.aspx>

¹⁴ Në janar 2011, EULEX-i ka hapur një hetim paraprak rreth dyshimeve në lidhje me rrëmbimin e serbëve në vitin 1999 dhe transferimin e tyre të mëvonshme në Shqipëri. Në qershor 2011, një Task Forcë nga Brukseli e EULEX-it ishte miratuar për të kryer hetimin dhe në gusht 2011 John Clint Williamson është emëruar Prokuror udhëheqës për Task Forcën Speciale Hetuese.

¹⁵ Komunikatë për shtyp e Amnesty International, 27 gusht 2013 në “Amnesty International UK/www.amnesty.org”.

9. Në mungesë të mjeteve të tjera efektive në Kosovë, në dispozicion të atyre, të cilëve iu kanë shkelur të drejtat e njeriut nga UNMIK-u, Amnesty International i kërkon PSSP-së së UNMIK-ut:
10. Të shfrytëzoj kompetencat që i ka nga OKB-ja dhe diskrecionin e ofruar në zyrën e PSSP-së, për të siguruar në përputhje me standardet ndërkombëtare që ata të cilët PKDNj-ja i ka konsideruar se iu kanë shkelur të drejtat e njeriut nga ana e UNMIK-ut të kenë qasje në kompensim, duke përfshirë qasjen në drejtësi dhe dëmshpërblim të përshtatshëm dhe efektiv, duke përfshirë kthimin, kompensimin, rehabilitimin, plotësimin dhe garancitë e mospërsëritjes;
11. Të arrihet një marrëveshje me EULEX-in për të siguruar përmbushjen e rekomandimeve të PKDNj-së se EULEX-i dhe autoritetet e tjera kompetente, duke përfshirë Prokurorinë Speciale të Republikës së Kosovës, duhet të hapin apo të vazhdojë hetimet penale në rastet e personave të zhdukur që janë parashtruar pranë PKDNj-së, në mënyrë që të dyshuarit për përgjegjësi penale të sillen para drejtësisë në gjykime të drejta;
12. Të sigurohet që UNMIK-u të ofroj fonde të mjaftueshme për t'iu siguruar të afërmve të personave të zhdukur kompensim të duhur dhe efektiv ose dëmshpërblim moral, atëherë kur rekomandohet nga PKDNj-ja, përfshirë në rastet e shkeljeve të nenit 3 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, kompensim i përshtatshëm dhe efektiv për dhembjet dhe vuajtjet e tyre;
13. T'i ofroj të njëjtën konsideratë për të gjitha ankesat e tjera që janë vendosur nga PKDNj-ja, rreth të cilave janë bërë rekomandime në lidhje me hetimet dhe dëmshpërblimet tek Zyra e PSSP-së;
14. Amnesty International gjithashtu i kërkon policisë dhe prokurorëve të EULEX-it që të hetojnë të gjitha rastet e pazgjidhura të rrëmbimet dhe vrasjet e dyshuara të pas luftës, duke përfshirë ato raste që janë parashtruar pranë PKDNj-së dhe ato që janë bartur nga Prokurori Special i Republikës së Kosovës (PSRK) në gjykatat vendore.

8.5. Vendimi i papranueshmërisë i Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut në lëndën Azemi kundër Serbisë

Lënda nr. 11209/09 (vendimi i datës 5 nëntor 2013)

Lënda kishte të bënte me një qytetar të Kosovës, i cili me sukses e kishte kundërshtuar ndërprerjen e marrëdhënies së punës së tij pranë Gjykatës Komunale të Ferizajt në Kosovë. Megjithatë, urdhri i gjykatës për ta rikthyer aplikantin në vendin e tij të punës asnjëherë nuk ishte zbatuar. Aplikanti ka parashtruar ankesë kundër Serbisë në lidhje me moszbatimin e vendimit të Gjykatës Komunale. Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut (GJEDNj) ka gjetur se autoritetet e Serbisë nuk kanë ushtruar ndonjë kontroll efektiv në Kosovë që nga viti 1999.

Prandaj, GJEDNj-ja nuk mund të "theksoj asnjë detyrim pozitiv që [Serbia] kishte ndaj aplikuesit" dhe se "[mund] mos të mbahet përgjegjës sipas nenit 1 të Konventës për moszbatimin e vendimit të Gjykatës Komunale" rreth së cilës është ankuar aplikanti. GJEDNj-ja ka arritur në përfundim se kërkesa ishte *ratione personae* jo e përputhshme dhe ka shpallur atë të papranueshme.

Në vendimin *Azemi*, GJEDj-ja ka pranuar për herë të parë ndonjëherë ekzistencën e juridiksionit të Panelit për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut të BE-së si më poshtë:

"Në Opinionin e tij rreth mekanizmit ekzistues për të shqyrtuar pajtueshmërinë me standardet e të drejtave të njeriut të veprimeve nga ana e UNMIK-ut dhe EULEX-it në Kosovë (nr. 545/2009, CDL-AD (2010) 051), Komisioni i Venecias ka përshëndetur themelimin e Panelit Këshillëdhënës për të Drejtat e Njeriut të UNMIK-ut ("Paneli") dhe i ka bërë thirrje Panelit dhe UNMIK-ut të gjej një zgjidhje në mënyrë që mbi 450 raste në pritje pranë Panelit të mund të kryhen para se UNMIK-u të largohet nga Kosova.

Komisioni i Venecias ka përshëndetur po ashtu edhe themelimin e Panelit për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut të EULEX-it. Paneli është themeluar në bazë të vendimit të Bashkimit Evropian të datës 20 nëntor 2009 dhe është bërë funksional më 9 qershor 2010. Mandati i tij është që të shqyrtoj shkeljet e pohuara të të drejtave të njeriut të kryera nga EULEX-i gjatë ushtrimit të mandatit të tij ekzekutiv. Ai i parashtron gjetjet e tij në EULEX dhe atëherë kur është e nevojshme bën rekomandime për veprime korigjuese".

9. E ardhmja e EULEX-it dhe sfidat e të drejtave të njeriut që del përpara

Ristrukturimi i propozuar i EULEX-it që është vendosur se do të ndodhë në qershor të vitit 2014 ngre një sërë shqetësimesh lidhur me mbrojtjen efektive të të drejtave të njeriut. Në këtë moment, është e panjohur për Panelin nëse EULEX-i do të ristrukturohet apo si i tillë do të pushoj së ekzistuari për t'u zëvendësuar nga një tjetër Misioni i CSDP-së. Në secilin rast, mund të pritët në mënyrë të arsyeshme se EULEX-i ose si alternativë një tjetër Misioni i ardhshëm i CSDP-së (Politikës së përbashkët për mbrojtje dhe siguri) me një emër tjetër do të mbajë disa kompetenca ekzekutive të paktën në lidhje me hetimin, ndjekjen penale dhe gjykimin e disa kategorive të krimeve.

Më tej, pas zbatimit të marrëveshjes për dialog ndërmjet Prishtinës dhe Beogradit mund të pritët që disa kompetenca ekzekutive do të mbahen sa i përket veriut të Kosovës. Përveç kësaj, pavarësisht prej natyrës ose kualifikimit të saktë të mandatit të misionit të ardhshëm ("ekzekutiv" ose ndryshe) është thelbësore që misioni i BE-së duhet të sigurojë që personeli i tij duhet të vazhdojë të veprojë në përputhje dhe me qëllim që të përkrah respektimin e plotë të standardeve përkatëse të të drejtave të njeriut.

Paneli ka identifikuar këto pika në vijim si çështjet më të ngutshme të drejtave të njeriut që duhet të shqyrtohen nga udhëheqja e BE-së dhe EULEX-it në kuadër të këtij procesi:

- i. Nëse EULEX-i duhet të zëvendësohet nga një mision tjetër i CSDP-së (Politikës së përbashkët për mbrojtje dhe siguri) në Kosovë me kompetenca ekzekutive, një mision i tillë do të duhet t'i nënshtrohet një mekanizmi llogaridhënës të jashtëm për të shqyrtuar shkeljet e pohuara të të drejtave të njeriut nga ai mision. Andaj Paneli për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut do të duhet të jetë pjesë e kuadrit ligjor në një mision të ristrukturuar. Siç u theksua më lartë, edhe një mandat jo ekzekutiv apo vetëm pjesërisht ekzekutiv nuk duhet të ndikojë në angazhimin e misionit dhe përgjegjësinë për të siguruar pajtueshmëri me standardet e njohura ndërkombëtare të të drejtave të njeriut.
- ii. Duke u bazuar në përvojën e Panelit, themelimi i një misioni të ri të CSDP-së (Politikës së përbashkët për mbrojtje dhe siguri) do të paraqesë mundësinë për të rritur efektivitetin e Panelit për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut, gjithashtu duke zgjeruar autoritetin e tij:
 - a. Pavarësia e Panelit mund të forcohet në mënyrë të konsiderueshme me krijimin e një institucioni të veçantë dhe të pavarur nga Misioni i CSDP-së (Politikës së përbashkët për mbrojtje dhe siguri). Një pavarësi e tillë nuk do të thotë vetëm pavarësi operacionale, por në të njëjtën kohë edhe autonomi administrative.

Një Panel vërtetë i pavarur do të kërkonte buxhetin e vet, ndër të tjera për qëllime të fushatës informuese në terren. Një mekanizëm llogaridhënës që kërkon miratim buxhetor për të gjitha veprimet e planifikuara, duke përfshirë marrëdhëniet me publikun nga institucioni të cilin e mbikëqyr, në mënyrë të pashmangshme do të shihen si i varur nga po ai institucion.

Përderisa EULEX-i ofron përkrahje të konsiderueshme administrative, vetë fakti se Paneli dhe Sekretariati i tij duhet të shfrytëzojnë makinat e EULEX-it, përdorin shenjat e EULEX-it dhe janë në kontratë me shefin e Misionit mund të çojë në një perceptim të varësisë nga ana e ankuesve si dhe nga publiku sa i përket pavarësisë institucionale dhe operacionale të Panelit.

- b. Në interes të transparencës, këshillohet fuqishëm që dokumentet themeltare të Panelit, posaçërisht Koncepti llogaridhënës të deklasifikohet nga institucionet përkatëse evropiane. Për shembull, fakti se Koncepti llogaridhënës i EULEX-it i datës 29 tetor 2009 për themelimin e Panelit për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut konsiderohet i kufizuar, në mënyrë të pashmangshme ndikon negativisht në perceptimin e transparencës së Panelit.
- c. Aktivitetet e Panelit shtrihen përtej shqyrtimit të ankesave dhe marrjes së vendimeve. Paneli i ardhshëm do të përfitojnë nga shërbimet e një zyrtari të përkushtuar për marrëdhënie me publikun me një buxhet të mjaftueshëm në dispozicion të tij/saj, që do ta adresoj mungesën shqetësuese që mbretëron sa i përket njohjes së Panelit në mesin e popullatës.
- d. Disa komentues, duke përfshirë edhe Këshillin e Evropës, kanë vënë në dukje si mangësi se rekomandimet e Panelit nuk janë detyruese dhe se EULEX-i nuk është i detyruar të veprojë sipas tyre. Si një kufizim i mëtijshëm është vënë re se Paneli nuk ka autorizim të rekomandoj pagesën e kompensimit nga ana e EULEX-it.

Paneli fton BE-në që të rishqyrtoj këto çështje në kuadër të mekanizmave të llogaridhënies për misionet e ardhshme të CSDP-së. Besueshmëria dhe efektiviteti i Panelit si një mekanizëm llogaridhënës do të rritet në masë të madhe duke i dhënë atij mundësi që të merr vendime dhe rekomandime detyruese, ndonëse shumat maksimale mund të vendosen.

- iii. Vazhdimi i ekzistencës së Panelit duhet të sigurohet në rast se misioni zvogëlohet ose ristrukturohet me një mandat në mënyrë që ta përfundoj shqyrtimin e lëndëve të pazgjidhura (Rregullorja e punës, iu drejtohet paragrafit 25, nën paragrafit 2 dhe 3).

10. Vërejtjet përfundimtare

1. Si në vitet e mëparshme, Paneli ka rekomanduar përsëri se BE-ja dhe EULEX-i duhet të adresojnë kërkesat e Panelit për të lehtësuar një zgjerim të konsiderueshëm të fushatës informuese në terren, në veçanti nisjen e transmetimeve në TV dhe radio.
2. Paneli ka rekomanduar se qëllimi i vetëdijesimit më të madh rreth të drejtave të njeriut në tërë misionin e EULEX-it vazhdon të ushtrohet në mënyrë aktive. Në këtë kontekst, Paneli rekomandon që BE-ja dhe EULEX-i të sigurojë se mbrojtja efektive e të drejtave të njeriut në Kosovë është dhe mbetet çështje me përparësi në trajnimin e personelit të ri të EULEX-it.

Një trajnim i tillë mund të shtrihet edhe në divizionet dhe njësitë përkatëse të EULEX-it për të siguruar një njoftim të zakonshëm rreth obligimeve të EULEX-it ndaj të drejtave të njeriut të EULEX-it nga personeli i EULEX-it. Natyrisht, pjesëtarët e personelit të EULEX-it kanë prejardhje të ndryshme kombëtare dhe profesionale. Ata kanë nivele të ndryshme të shkollimit dhe të njohjes së të drejtave të njeriut dhe të drejtat e njeriut kanë pasur nivele të ndryshme të rëndësisë në shtetet e tyre prej nga vijnë. Kjo mund të adresohet në mënyrë efektive duke siguruar standarde të përbashkëta për të gjithë anëtarët e personelit të misionit.

3. Paneli rekomandon që EULEX-it të përpiqet të zbatoj të gjitha mekanizmat e nevojshme në kuadër të misionit dhe të caktoj burime të mjaftueshme për t'u marrë menjëherë dhe në mënyrë efektive me kërkesat e Panelit për informata në lidhje me ankesat e parashtruara në Panel. Deri më sot janë kërkuar dokumente shtesë në shumë prej lëndëve që janë komunikuar, duke shkaktuar vonesa në shqyrtimin e lëndëve.
4. Paneli rekomandon që BE-ja dhe EULEX-i ta bëjë respektimin e të drejtave të njeriut prioritet të strategjisë së tyre të ristrukturimit dhe po ashtu të siguroj se ekzistojnë të gjitha procedurat dhe mekanizmat e nevojshme për të garantuar dhe për të mbrojtur këto të drejta atëherë kur EULEX-i ta ketë përfunduar mandatin e vet. Në veçanti, Paneli rekomandon që BE-ja dhe EULEX-i të marrin në konsideratë nevojën për të forcuar, në kuptimin institucional një mekanizëm llogaridhënës për misionin e ardhshëm të CSDP-së në Kosovë.
5. Paneli rekomandon që BE-ja dhe EULEX-i të siguroj që angazhimi i shteteve anëtare të BE-së dhe për rrjedhojë angazhimi i vet për të mbështetur standardet e njohura ndërkombëtare të të drejtave të njeriut të zbatueshme në Kosovë duhet të mbetet reale, konkrete dhe efektive. Prandaj, Paneli rekomandon që EULEX-i në Kosovë të vazhdoj të jetë i angazhuar plotësisht në promovimin dhe respektimin e të drejtave të njeriut në gjithë gamën e aktiviteteve të ndërmarra nga EULEX-i.

Për më shumë informata rreth Panelit shih www.hrrp.eu.

SHTOJCA 1**Tabela e personelit**

Paneli	
Magda Mierzevska	Kryesuese e Panelit
Guénaël Mettraux	Anëtar i Panelit Nga 01 tetor 2012
Katja Dominik	Anëtare e Panelit, gjykatëse e EULEX-it
Elka Filcheva-Ermenkova	Anëtare zëvendësuese e Panelit, gjykatëse e EULEX-it

Secretariat	
John J. Ryan	Zyrtar i lartë ligjor
Joanna Marszalik	Zyrtar ligjor
Florian Razesberger	Zyrtar ligjor
Shpresa Gosalci	Asistente administrative/gjuhësore (shqip-anglisht)
Katica Kovacevic	Inteprete/përkthyes (serbisht-anglisht)
Kushtrim Xhaferi	Interpret/përkthyes (shqip-anglisht)

SHTOJCA 2 Orari i fushatës informuese dhe aktivitetet e tjera

Datë	Vendi	Ngjarja
22/01/13	Mitrovica e veriut	Takim me znj. Zlata Radovanovic, bashkërenduese e zyrës për Kosovë & Metohi
29/01/13	Ndërtesa e PShDNj-së	Takim me PILPG; Michael Kovaka (MK) – Shef i partisë, Agon Gashi (AG) – zyrtar ligjor i programit
21/02/13	Zyra e Avokatit të Popullit, Kosovës	Takim me z. Sami Kurteshin, Avokat i Popullit të Kosovës; zëvendës Avokat i Popullit dhe zëdhënës i Institucionit të Avokatit të Popullit (IAP), znj. Majlindë Sinani-Lulaj.
08/03/13	Ferizaj	Takim me z. Samir Reka, bashkërendues i projektit
08/03/13	Manastiri i Pejës	Takim me peshkopin Jovan Culibrk, peshkop i Ulpiana Jovan-it, famullitar i patriarkanës serbe
11/03/13	OSBE - Pejë	Takim me drejtorin e Qendrës Rajonale të OSBE-së në Pejë, z. Norman Spitzegger
11/03/13	OJQ-ja ESG Gorazhdevc	OJQ Studio Grup eksperimentale, z. Sasa Petrovic
13/03/13	Këshilli për paqe dhe të drejta të njeriut, Saferworld, Prizren	Takim me z. Musa Vezgishi, Drejtor ekzekutiv
13/03/13	Gjykata themelore, Prizren	Takim me z. Ymer Hoxhën
14/03/13	Beograd	Projekt: Mbështetje për zbatimin e strategjive për të ZhBV, refugjatë dhe të kthyerit
14/03/13	Beograd	Takim me Asociacionin e personave të zhdukur (AMP), Massimo Moratti (MM)
25/03/13	Kryesia e Bashkësisë Islame, Prishtinë	Takim me kryetarin e Bashkësisë Islame të Kosovës, z. Naim Ternava
26/03/13	Zyra për Kosovë dhe Metohi	Takim me znj. Zlata Radovanovic, bashkërenduese e zyrës për Kosovë dhe Metohi, znj. Bratislava Radovanovic, zyrtare e zyrës për Kosovë dhe Metohi
23/04/13	Drejtoria qendrore e OSBE-së, Prishtinë	Takim me Cornelius Nolan, zyrtar i lartë për demokratizim në RC Prishtinë
29/04/13	OJQ-ja HUMKOS, Graçanicë	Takim me Ljubinko Todorovic (LT) – Kryetar i HUMKOS-it
29/04/13	Prishtinë	Takim me Qendrën juridike të Kosovës (QJK)
08/05/13	Mitrovicë	Takim me zyrtarë ligjorë nga projekti: Mbështetje në zbatimin e strategjive për persona të zhvendosur brenda vendit (PZhBV), refugjatët dhe të kthyerit, një zyrtar nga zyra për Kosovë dhe Metohi
14/05/13	Mitrovicë	Takim, Rrjeti veprues i politikave kosovare, z. Andreja Mijanovic
21/05/13	Selia e peshkopit, Prishtinë	Takim me Don Lush Gjergjin, Famullitar i Përgjithshëm i kishës katolike në Kosovë
23/05/13	Ndërtesa e PShDNj-së	Takim me Xhevdet Halilin, drejtor i KLC, Vittorio di Giacomo, menaxher i programit

27/05/13	Këshilli për paqe dhe të drejta të njeriut, Saferworld, Prizren	Takim me z. Musa Vezgishin, drejtor ekzekutiv
27/05/13	Asociacioni "Gjimnazi Loyola", Prizren	Takim me Asociacionin "Gjimnazi – Loyola", atin Walter Happel SJ, drejtor ekzekutiv
27/05/13	Zyra e OSBE-së, Pejë	Takimi ndërmjet agjencive, akterë ndërkombëtarë në Pejë
03/06/13	Mitrovicë	Takim me z. Aleksandar Stojanovic, Rrjeti veprues i politikave kosovare
10/06/13	Kisha orodokse serbe, Prishtinë	Takim me atin Stevo Mitric-in
11/06/13	Baza e UNMIK-ut, Mitrovicë	Takim ndërmjet agjencive, akterë ndërkombëtarë në Mitrovicë
12/06/13	Ndërtesa e PShDNj-së	Takim me Adam Juszcak, zyrtar ndërlidhës i drejtësisë dhe Celine Ruiz, zyrtare politike, CPCC
19/06/13	Osojanë (Klinë)	Takim me atin Milos Vukic-in
19/06/13	Istog	Takim me atin Jovica Vloiskovic-in
20/06/13	Kamenicë	Takim me Nebojsa Simic-in, Drejtor, Rrjeti veprues i politikave kosovare
27/06/13	Gjilan	Takim me shefin e zyrës së OSBE-së, Gjilan
01/07/13	Hoteli Sirius, Prishtinë	Tryezë e rrumbullakët për parandalimin e torturës nën patronatin e Avokatit të Popullit të Kosovës
16/07/13	OSBE, Prizren	Takim me Sara Bonotti, shefe e zyrës/zyrtare e lartë për të drejta të njeriut në QR Prizren dhe Meriton Pajaziti, vëzhgues i sitemit ligjor
17/07/13	Kisha në Graçanicë	Takim me atin Ilarion, Famullitar i manastirit të Dragancës, rajoni i Gjilanit
23/07/13	Ndërtesa e PShDNj-së Prishtina	Takim me Anton Nrecaj, jurist për ndihmë ligjore, Qendra për ndihmë ligjore dhe zhvillim rajonal, (CLARD) Kosovë
20/08/13	Mitrovica, Kosovo	Takim me z. Oliver Ivanoviç-in, kryetar i nismës qytetare serbe "Serbia, Demokracia dhe drejtësia"
18/10/13	Prishtinë	Tryezë e rrumbullakët "Zhurma dhe ndikimi i saj në të drejtat e njeriut"
29/10/13	Gjykata themelore, Prishtinë	Takim me z. Hamdi Ibrahimimi, kryetar i gjykatës themelore, Prishtinë
30/10/13	Hoteli Sirius Prishtinë	Tryezë e Diskutimeve: "Zbatimi i drejtësisë"
04/11/13	NGO offices in Štrpce/Shtërpçë	OJQ-ja "Dona" - Snezana Arsic & OJQ-ja "E ardhja ma frikë" Igor Savic
06/11/13	Gjykata e Apelit në Prishtinë	Takim me z. Salih Mekaj, kryetar i gjykatës së Apelit
13/11/13	Gjykata kushtetuese në Prishtinë	Takim me z. Enver Hasani, kryetar i gjykatës kushtetuese
14/11/13	Zyra e prokurorisë në Prishtinë	Takim me z. Ismet Kabashi, kryeprokuror i shtetit
20/11/13	Zyra e prokurorisë së apelit	Takim me z. Aleksander Lumezi, zyra e kryeprokurorit të apelit

21/11/13	Gjykata supreme në Prishtinë	Takim me z. Fejzullah Hasanin, kryetar i gjykatës supreme
21/11/13	Hoteli Affa në Prishtinë	Tryezë e rrumbullakët “Realizimi i misionit të Institucionit të Avokatit të Popullit”

SHTOJCA 3 Statistikat 2010 - 2013

Kohëzgjatja mesatare e procedurave në Panel është rreth 180 ditë, pra gjashtë muaj.

	2010	2011	2012	2013	Gjithsej
Lëndët e regjistruara - Gjithsej	16	28	23	27	94
Lëndët e përfunduara - Gjithsej	6	30	12	18	66
Të pranueshme			2*		2
Të papranueshme	6	22	10	13	51
Shkelje	0	2	0	7	9
Nuk ka shkelje	0	5	0	0	5
Të hequra në lista	0	1	0	0	1

*Lëndët jo të përfunduara

Statistikat	Më 31 dhjetor 2012
Në pritje	28
Të pranueshme	2
Të papranueshme	51
Shkelje	9
Nuk ka shkelje	5
Të hequra në lista	1
Lëndët e regjistruara prej qershorit të vitit 2010 – Gjithsej	94

Të përfshirë në ankesa	
Divizioni Ekzekutiv	80
Individë/ndërmarrje private	14
Gjithsej	94

SHTOJCA 4
Vendimet e PShDNj-së 2010-2013

	Lënda	Ankuesi	Subjekti	Rezultati
1.	2010-01	Djeljalj Kazagic	Dyshohet në mos veprim nga prokurori i EULEX-it, çështje pronësore	Shkelje
2.	2010-02	Sadik Thaqi	Dyshohet në mos veprim nga prokurori i EULEX-it, vdekje në burgun e Dubravës, 04/09/2003	Nuk ka shkelje
3.	2010-03	Osman Mehmetaj	Dyshohet në mos veprim nga prokurori i EULEX-it, vdekje në burgun e Dubravës, 04/09/2003	Nuk ka shkelje
4.	2010-04	Feti Demolli	Dyshohet në mos veprim nga prokurori i EULEX-it, vdekje në burgun e Dubravës, 04/09/2003	Nuk ka shkelje
5.	2010-05	Mursel Hasani	Dyshohet në mos veprim nga prokurori i EULEX-it, vdekje në burgun e Dubravës, 04/09/2003	Nuk ka shkelje
6.	2010-06	Latif Fanaj	Dyshohet në mos veprim nga prokurori i EULEX-it, vdekje në burgun e Dubravës, 04/09/2003	Nuk ka shkelje
7.	2010-07	Blerim Rudi	Dyshohet në mos zbatim të urdhrit të lëshuar nga Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për rikthim në punë të ankuesit nga ana e Njësisë së Inteligjencës Financiare.	Shkelje
8.	2010-08	Delimir Krstic	Dyshohet në mos veprim nga policia dhe prokuroria e EULEX-it, çështje pronësore	E papranueshme
9.	2010-09	Burim Ramadani	Dyshohet në mos-funksionim të sistemit gjyqësor, rasti Kiçina	E papranueshme
10.	2010-10	Horst Proetel	Kandidaturë jo e suksesshme në një pozitë në EULEX	E papranueshme
11.	2010-11	Laura Rudi	Ankesë private financiare ndaj një punëtori të EULEX-it	E papranueshme
12.	2010-12	Hunaida Pasuli	Kandidaturë jo e suksesshme në një pozitë pune në EULEX	E papranueshme
13.	2010-13	Një punëtor i EULEX-it	Kontest i brendshëm në EULEX lidhur me vlerësimin e punës dhe marrëdhëniet personale me mbikëqyrësin	E papranueshme
14.	2010-14	Lulzim Gashi	Kandidim jo i suksesshme në një pozitë pune në EULEX	E papranueshme

	Lënda	Ankuesi	Subjekti	Rezultati
15.	2010-15	Faton Sefa	Mos rikthimi në vendin e mëparshëm të punës (sektor privat), dyshohet në mos zbatim të vendimit të gjykatës	E papranueshme
16.	2010-16	Cyma Agovic	Transferuar nga EULEX-i – Mos shqyrtim i drejtë i lëndës së ankueses nga ana e gjykatësve të EULEX-it	E papranueshme
17.	2011-01	Familja e Dedë Gecajt	Kërkesë për hetim të vendimit të gjykatave të EULEX-it në Kosovë për ekstradim në rastin e të ndjerit Dedë Gecaj	E papranueshme
18.	2011-02	Chamalagai Krishna Bahadur	Dyshohet në mos veprim	E papranueshme
19.	2011-03	Afrim Mustafa	Kontest në lidhje me një radio stacion privat dhe konfiskimi i pajisjeve të radio stacionit	E papranueshme
20.	2011-04	Besim Berisha	Ankesë rreth kushteve të jetës në burgun e Dubravës	E hequr nga lista e ankesave
21.	2011-05	SH.P.K “Syri”	Dyshohet në mohim të së drejtës për gjykim të drejtë, liri të shprehjes dhe barazi para ligjit, SCSC.	E papranueshme
22.	2011-06	Milazim Blakqori	Dyshohet në moszbatimin e një vendimi, mosveprim nga ana e EULEX-it	E papranueshme
23.	2011-07	Lënda W	Dyshim në shkeljen e nenit 6 të KEDNJ-së	Shkelje
24.	2011-08	Anton Rruka	Dyshohet në mohim të së drejtës për gjykim të drejtë, liri të shprehjes dhe barazi para ligjit, SCSC.	E papranueshme
25.	2011-09	Mirkovic Bojan	Dyshohet në largim nga puna në mënyrë të paligjshme nga EULEX-i	E papranueshme
26.	2011-10	Dejan Jovanovic	Dyshohet në vonesë të panevojshme gjatë procedurave në SCSC.	E papranueshme
27.	2011-11	Srecko Martinovic	Dyshohet në përdorim të tepruar të forcës, trajtim dhe mohim të së drejtës për gjykim të drejtë	E papranueshme
28.	2011-12	Novica Trajkovic	Dyshohen në përdorim të tepruar të forcës	E papranueshme
29.	2011-13	S.M.	Dyshohet në përdorim të tepruar të forcës, mohim të së drejtës për gjykim të drejtë dhe mos respektim të jetës private	E papranueshme
30.	2011-14	Lindita Shabani	Dyshohet në mohim të së drejtës për jetë private dhe familjare	E papranueshm

	Lënda	Ankuesi	Subjekti	Rezultati
				e
31.	2011-15	Samedin Smajli	Dyshohet në mohim të gjykimit të drejtë dhe vonesë të panevojshme gjatë procedurave	E papranueshme
32.	2011-16	Avdyl Smajli	Dyshohet në mohim në gjykim të drejtë dhe vonesë të panevojshme gjatë procedurave	E papranueshme
33.	2011-17	Faik Azemi	Dyshohet në mohim të së drejtës për gjykim të drejtë	E papranueshme
34.	2011-18	Mykereme Hoxha	Dyshohet në mos veprim nga prokurori i EULEX-it	E papranueshme
35.	2011-19	Sefer Sharku	Dyshohet në mos respektim të një vendimi detyrues gjyqësor.	E papranueshme
36.	2011-21	Ventor Maznikolli	Dyshohet në vonesë të panevojshme nga gjykatësit e EULEX-it rreth caktimit të një seance në Gjykatën Supreme.	E papranueshme
37.	2011-22	Hysni Gashi	Dyshohet për mohim të një gjykimi të drejtë dhe dyshohet në paaftësi të gjykatësve të EULEX-it.	E papranueshme
38.	2011-23	Hashim Rexhepi	Dyshohet në shkelje të së drejtës për liri dhe të së drejtës për gjykim të drejtë.	E papranueshme
39.	2011-24	Predrag Lazic	Dyshohet në mos caktimin e një gjykimi të drejtë brenda një afati të arsyeshëm.	E papranueshme
40.	2011-25	Shaip Gashi	Dyshohet në privim nga pensioni gjerman për persona me paftësi.	E papranueshme
41.	2011-26	Njazi Asllani	Dyshohet në mos zbatim të një vendimi, mos veprim nga EULEX-i	E papranueshme
42.	2011-28	Lënda Y	Dyshohet në shkelje të së drejtës për respektimin e jetës private dhe familjare.	E papranueshme
43.	2012-01	Qamil Hamiti	Dyshohet në mohim të së drejtës për gjykim të drejtë.	E papranueshme
44.	2012-02	Arben Zeka	Dyshohet për mos gjykim të një lënde pronësore.	E papranueshme
45.	2012-03	Rexhep Dobruna	Dyshohet në mohim të së drejtës për gjykim të drejtë.	E papranueshme

	Lënda	Ankuesi	Subjekti	Rezultati
46.	2012-04	Izet Maxhera	Kontest pronësor me EULEX-in në Mitrovicë.	E papranueshme
47.	2012-05	Fatmir Pajaziti	Dyshohet në shkelje të së drejtës për liri dhe gjykim të drejtë.	E papranueshme
48.	2012-06	Lënda Z	Dyshohet në shkelje të nenit 10 dhe 11 të DUDNj-së, nenet 5 dhe 6 të KEDNj-së, nenit 9 të KDDCP-së dhe neni 6 i KKT-së	E papranueshme
49.	2012-07	Lënda I	Dyshohet në mosveprim nga ana e prokurorit të EULEX-it dhe policisë së EULEX-it	E papranueshme
50.	2012-08	Lënda U	Dyshohet në shkelje të nenit 6 të KEDNj-së	E papranueshme
51.	2012-09	Lënda A	Dyshohet në shkelje të neneve 2, 3, 8, 9, 10 and 11 KEDNj-së	Shkelje
52.	2012-10	Lënda B	Dyshohet në shkelje të neneve 2, 3, 8, 9, 10 and 11 KEDNj-së	Shkelje
53.	2012-11	Lënda C	Dyshohet në shkelje të neneve 2, 3, 8, 9, 10 and 11 KEDNj-së	Shkelje
54.	2012-12	Lënda D	Dyshohet në shkelje të neneve 2, 3, 8, 9, 10 and 11 KEDNj-së	Shkelje
55.	2012-13	Bejtush Gashi	Dyshohet në shkelje të nenit 6 KEDNj-së dhe nenin 1 të protokollit 1 të KEDNj-së	E papranueshme
56.	2012-15	Shefqet Emërllahu	Dyshohet në shkelje të nenit 6 të KEDNj-së, moshetim	E papranueshme
57.	2012-16	Kristian Kahrs	Dyshohet në shkelje të nenit 6 të KEDNj-së, mosveprim	E papranueshme
58.	2012-17	Lënda E	Dyshohet në shkelje të nenet 5 dhe 6 të KEDNj-së	E papranueshme
59.	2012-18	Hamdi Sogojeva	Dyshohet në shkelje të nenit 1 të protokollit 1 të KEDNj-së	E papranueshme
60.	2012-19	Lënda H	Dyshohet në konfiskim të pronës	Shkelje
61.	2012-20	Lënda G	Dyshohet në shkelje të neneve 3, 10, 11 të KEDNj-së dhe nenit 1 të protokollit 1 të KEDNj-së	Shkelje
62.	2013-01	Lënda I	Dyshohet në shkelje të nenit 6 të KEDNj-së	E papranueshme

	Lënda	Ankuesi	Subjekti	Rezultati
63.	2013-02	Arsim Krasniqi	Dyshohet në shkelje të nenit 3 të KEDNj-së	E papranueshme
64.	2013-16	Almir Susaj	Dyshohet në shkelje të nenit 3 and 8 të KEDNj-së	E papranueshme
65.	2013-19	Lënda U	Dyshohet në shkelje të nenit 1 të protokollit 1 të KEDNj-së	E papranueshme
66.	2013-20	Shaip Gashi	Dyshohet në shkelje të nenit 1 të protokollit 1 të KEDNj-së	E papranueshme